



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 13 (827765)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 Prill 2022

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Falënderues për realizimin me sukses të objektivave, krah aleatëve tanë strategjikë

Është kthyer në atdhe kontingjenti i Policisë Ushtarake, i cili mori pjesë në operacionin "Allied Solace" të drejtuar nga NATO, në Kosovë në përbërje të "Task Force Noble". Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, në përshëndetjen e tij drejtuar trupave në ceremoninë e organizuar me këtë rast, shprehu falënderimet më të mira për personelin e Policisë Ushtarake në

realizimin e detyrave me përpikmëri dhe përkushtim, në operacionin e NATO-s, "Allied Solace", duke përcjellë edhe vlerësimet nga autoritetet dhe komandat e NATO-s. "Ky operacion u angazhua në mënyrë të shpejtë dhe në përgjigje të menjëhershme të Shqipërisë ndaj krizës afgane. Ai u planëzua dhe ekzekutua në një kohë rekord, duke i përmbushur me sukses të gjitha objektivat dhe duke dëshmuar

rëndësinë e solidaritetit dhe kohezionit ndërmjet vendeve anëtare të Aleancës. Kontributi që Shqipëria ka dhënë në këtë operacion ka marrë vlerësime të larta nga Komanda Operacionale, Strategjike dhe autoritetet më të larta të NATO-s ..." – u shpreh ndër të tjera shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj. Operacioni "Allied Solace" u aktivizua nga Forca e Reagimit të NATO-s në... » faqe 2



77 - Vjetori i shkollës "Skënderbej"

Zv. ministrja Bici: Respekt për punën dhe sakrificën tuaj në vite



Një jetë në kolanën e artë "Skënderbegasit ndër vite"



Kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Konferencën e Komandantëve Operacionalë të FD të NATO-s

Me ftesë të Komandantit të Forcave Detare të Aleancës (MARCOM) nënadmiralet Kith Blount, CB OBE, në Komandën e Forcave Detare të NATO-s, Northwood, Londër, Mbretëria e Bashkuar, u zhvillua Konferenca e Komandantëve Operacionalë të Forcave Detare të NATO-s (MOCC-22). Në këtë konferencë morën pjesë komandantët e Forcave Detare të NATO-s, si dhe përfaqësues nga SHAPE dhe Komandat e Forcave të Bashkuara (JFC). Forca Detare e Shqipërisë u përfaqësua nga Komandanti i Forcës Detare...



» Faqe 2

Shkëmbim eksperiencash mes studentëve të FA dhe "West Point"

Dy studentët amerikanë nga Akademia Ushtarake e SHBA West Point, Sarah E. Traynor dhe Sebastien L. Morel, në kuadër të programit "West Point Exchange", gjatë muajit mars, qëndruan dhe shkëmbyen eksperiencën e tyre me studentët tanë të programit të ciklit të parë Bachelor në Shkencën Ushtarake, Viti II. Studentët amerikanë u integruan shpejt me kolegët e tyre shqiptarë, duke u aktivizuar edhe në rolin e drejtuesit të togës gjatë zhvillimit të taktikës në tema të ndryshme të saj. Ata gjithashtu patën...



» Faqe 6

Një vit pa gjeneral Ndrëçim Sallakun "Lamtumirë mik i mirë"

Një vit pa gjeneral Ndrëçim Sallakun, pa kolegun e përkushtuar, mikun e kudogjendur, shokun e dashur, bashkëshortin dhe babanë model! Shumë dhimbje e trishtim për ndarjen e parakohshme nga jeta të gjeneralit Brigadë Ndrëçim Sallakut, profesionistit të përkushtuar të Forcave të Armatosura. Përmbi tre dekada angazhim në ushtrinë shqiptare, ai shërbeu si rrallëkush nën uniformë, duke spikatur për aftësitë e tij drejtuese dhe organizative, ku dëshmoi gjithashtu vlera të larta humanizmi dhe bashkëpunimi siç dinte veç ai. Ushtarak karriere, ai realizoi...



» Faqe 5

Është kthyer në atdhe kontingjenti i Policisë Ushtarake, i cili mori pjesë në operacionin “Allied Solace” të drejtuar nga NATO, në Kosovë në përbërje të “Task Force Noble”.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, në përshëndetjen e tij drejtuar trupave në ceremoninë e organizuar me këtë rast, shprehu falënderimet më të mira për personelin e Policisë Ushtarake në realizimin e detyrave me përpikmëri dhe përkushtim, në operacionin e NATO-s, “Allied Solace”, duke përcjellë edhe vlerësimet nga autoritetet dhe komandat e NATO-s.

“Ky operacion u angazhua në mënyrë të shpejtë dhe në përgjigje të menjëhershme të Shqipërisë ndaj krizës afgane. Ai u planëzua dhe ekzekutua në një kohë rekord, duke i përmbushur me sukses të gjitha objektivat dhe duke dëshmuar rëndësinë e solidaritetit dhe kohezionit ndërmjet vendeve anëtare të Aleancës. Kontributi që Shqipëria ka dhënë në këtë operacion ka marrë vlerësime të larta nga Komanda Operacionale, Strategjike dhe autoritetet më të larta të NATO ...” – u shpreh ndër të tjera shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Operacioni “Allied Solace” u aktivizua nga Forca e Reagimit të NATO-s në muajin gusht 2021 në përgjigje të krizës së evakuimit të refugjatëve afganë.

Forcat e Armatosura të RSH kontribuan me një kompani të Policisë Ushtarake për një periudhë 6-mujore duke kryer detyra të ndryshme në kampin Bechtel, Kosovë.



KTHEHET NË ATDHE KONTINGJENTI I POLICISË USHTARAKE

Gjeneralmajor Bajram Begaj: Falënderues për realizimin me sukses të objektivave, krah aleatëve tanë strategjikë



KOMANDA E FORCAVE DETARE TË NATO-s, NORTHWOOD, LONDËR

Kundëradmiral Adnand Agastra mori pjesë në Konferencën e Komandantëve Operacionalë të Forcave Detare të NATO-s

Me ftesë të Komandantit të Forcave Detare të Aleancës (MARCOM) nënadmiralet Kith Blount, CB OBE, në Komandën e Forcave Detare të NATO-s, Northwood, Londër, Mbretëria e Bashkuar, u zhvillua Konferenca e Komandantëve Operacionalë të Forcave Detare të NATO-s (MOCC-22). Në këtë konferencë morën pjesë komandantët e Forcave Detare të NATO-s, si dhe përfaqësues nga SHAPE dhe Komandat e Forcave të Bashkuara (JFC). Forca Detare e Shqipërisë u përfaqësua nga Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra dhe kapiten i rangut III-të Blendi Melishte.

Qëllimi i aktivitetit ishte diskutimi mbi situatën e sigurisë në rajon,

ecurinë e Operacioneve dhe detyrave të kryera gjatë gjithë periudhës nga Grupet e Gatshme të Anijeve të NATO-s, pamjen e situatës së sigurisë detare si dhe stërvitjet e ndryshme nga Grupet e Gatshme të Anijeve të NATO-s.

Gjatë konferencës komandanti i Komandës Detare të Aleancës falënderoi të gjitha vendet e NATO-s për kontributin e tyre me anijet dhe personelin e gatshëm dhe duke u nisur nga ndryshimet e mjedisit të sigurisë në rajon, ripërsëriti kërkesën e drejtuar vendeve të NATO-s për rritjen e kontributit të tyre me mjete dhe personel në kuadër të rritjes së sigurisë detare të Aleancës.



Në ambientet e garnizonit “Skënderbej”, më 28 mars 2022, nën drejtimin e kryetarit të shoqatës Skënderbegasi “Nderi i Kombit”, Mikado Shakohoxha, u zhvillua një takim ceremonie me rastin e 77 vjetorit të krijimit të Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”.

Në këtë ceremoni përkujtimore morën pjesë zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Dallëndyshe Bici, këshilltari ushtarak i Presidentit, ish-zv/shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneral brigade Dedë Prenga, ish-ushtarakë që kanë kryer studimet ndër vite në shkollën “Skënderbej”, ish-mësues dhe punonjës që kanë punuar në këtë shkollë, si dhe mjaft të ftuar të tjerë.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i shoqatës kombëtare “Skënderbegasi”, Mikado Shakohoxha, i cili foli mbi historikun e shkollës ushtarake “Skënderbej”.

Të pranishmit i përshëndeti zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici. Gjatë fjalës së saj, zëvendësministria Bici vlerësoi punën që është bërë ndër vite në këtë shkollë, që nga dita e krijimit më 28 mars 1945 dhe deri sa u mbyll në vitin 1992. “Kjo është arritur në sajë të punës dhe sakrificave që nuk mund t’i mohojë asnjëri nga ne. Ju ishit ata që kaluat ndryshimet e viteve ’90 dhe përqaftuat reformat”, tha zëvendësministria e Mbrojtjes, e cila kujtoi me respekt edhe mësuesit që kanë edukuar brezat në shkollën “Skënderbej”.

Znj. Bici theksoi gjithashtu se, “është nder dhe emocion i veçantë, që në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe personalisht të ministrit Peleshi, të përshëndes ju skënderbegasit, pionierë dhe themelues të Shkollës së Mesme “Skënderbej”, shkollë që zë vend nderi dhe krenarie në historinë tonë ushtarake e veçanërisht në atë të arsimit ushtarak”.

“Si sot 77 vjet më parë, - tha ajo, -shkolla “Skënderbej” çeli portat e saj për t’u shndërruar më pas në një institucion dinjitoz e prestigjioz të përgatitjes dhe arsimimit të kuadrove të ardhshëm ushtarake.

Duke folur për vlerat e kësaj shkolle dhe të gjeneratave të nxënësve të saj, znj Bici nënvizoi se, kjo shkollë ka edukuar dhe përgatitur breza dhe gjenerata të nxënësve që ishin fidanishtja e ushtrisë shqiptare.

“Më lejoni që në këtë ceremoni përkujtimi dhe mirënjohjeje t’ju uroj shëndet e lumturi në familjet tuaja, jetë të gjatë si dhe ta ruani e ta transmetoni ndër breza frymën e unitetit të komunitetit të nderuar ushtarak”.

Në këtë takim ceremonie foli edhe ish-gjeneral brigade Dedë Prenga, i cili midis të tjerash tha se ish-Shkolla e Mesme “Skënderbej”



Shoqata “Skënderbegasi”, “Nderi i Kombit”, ceremoni përkujtimore

77-vjetori i shkollës “Skënderbej”, Bici: Respekt për punën dhe sakrificën tuaj në vite



Zv. ministrja Bici vlerësoi punën që është bërë ndër vite në këtë shkollë, që nga dita e krijimit, më 28 mars 1945 dhe deri sa u mbyll në vitin 1992.

ishite dhe mbetet një shkollë që ka treguar vlera të çmuara në çdo brez. “Ajo, ishte dhe mbetet një vlerë e pazëvendësueshme”, - tha ai. Gjithashtu ceremoninë e përshëndetën edhe ish-skënderbegas të tjerë si Bashkim Kozeli, një nga poetët ushtarakë, i cili recitoi dhe një prej krijimeve të tij kushtuar shokëve dhe shkollës “Skënderbej”.

Në fund të cermonisë, zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Dallëndyshe Bici dhe ish-zv/shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Dedë Prenga, shpërndanë certifikata mirënjohjeje në emër të ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, për personalitete të dalë nga shkolla, “Skënderbej”.

Batalioni i Mbështetjes Rajonale në ndihmë të shuarjes së zjarrit në Bashkinë Mat

Efektivët e Batalionit të Mbështetjes Rajonale të Komandës Mbështetëse janë angazhuar në operacione të shuarjes së zjarrit në Rukaj, Prellë, Rremull, Derjan, Dukagjin, Bashkia Mat. Si rezultat i punës së palodhur të bërë gjatë gjithë natës dhe deri në çeljen e agimit të ri, operacioni përfundoi me sukses duke bërë të mundur shuarjen e zjarrit në të gjitha zonat deri në vatrën e fundit në fshatin Derjan.

Ky operacion në të cilin morën pjesë 21 efektivë, u krye në bashkëpunim të ngushtë edhe me bashkinë Mat. Batalioni i Mbështetjes Rajonale ndodhet në gatishmëri për mbështetjen e komunitetit në nevojë kurdo dhe kudo që situata e kërkon.





PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
MJESHTËR I MADH

Një jetë në kolanën e artë "Skënderbegasit ndër vite"

Në kuadrin e 77-vjetorit të çeljes së Shkollës së Mesme Ushtarake, autorët Maksim Fejzulla & Kujtim Boriçi, promovuan volumin e katërt të librit "Skënderbegasit ndër vite" (Arkiva, personalitete dhe kujtime).


Në këtë ceremoni të organizuar në Muzeun Historik Kombëtar morën pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu, personalitete të fushave të ndryshme si dhe me pjesëmarrjen e brezave të skënderbegasve. Me vargjet e poetit brilant Arben Duka, i cili pak kohë më parë u nda nga jeta fizikisht, duke na lënë vargje të papërsëritëshme, kujtojmë të gjithë ata 'Skënderbegas' që nuk i kemi mes nesh dhe urojmë jetë të gjatë të gjithë atyre që flokët e bardhë fisnikërisht iu qëndrojnë mbi ballë.

Falënderoj dhe përgëzoj për këtë ndërmarrje të madhe të marrë në vite nga Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzulla, për të shkruar librin "Skënderbegasit ndër vite...", botim, vëllimi i parë ka dalë në vitin 2016 dhe vëllimi i katërt në vitin 2022. Urimë për këtë vepër disa vëllimshme që po na sillni në vite. Më këtë seri veprash për shkollën "Skënderbej", ju jo vetëm e keni lartësuar, dritësuar, siç ka qenë, por e keni bërë të përjetshme.

Tashmë, të gjithë ata që kanë studiuar, por dhe ata që kanë dëgjuar për historinë e lavdishme të kësaj shkolle model, kur vjen 28 marsi, kthejnë sytë në histori dhe përpara na shfaqet "Shkolla e pionierëve të luftës". Historia e lavdishme 50-vjeçare e kësaj shkolle, tashmë të hyrë në histori, siç ka hyrë në histori dhe shoqata e skënderbegasit, por tashmë edhe libri për skënderbegasit.

Autorët kanë theksuar në libër se nxënësit e parë të shkollës ishin partizanë nën moshën 15 vjeç e që vinin direkt nga radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Erdhën në shkollë me uniformë partizane dhe me pushkë në krah për t'u bërë quadro të ardhshëm të ushtrisë. Territori i shkollës ende i kishte gjurmët e luftës. Veprimet ditore prej pionierëve nuk bëheshin me bori, por me çangën e një gëzhgoje lufte artilerie. Brezi i parë i luftës ngeli shembull pozitiv për brezat që vijuan studimet në shkollë, për gjysmë shekulli dhe arritën rezultate të larta në mësim, në stërvitje ushtarake, në sport dhe në rrethe kulturore etj.

Gjatë shkrimit të biografisë së kësaj shkolle, autorët nga dashuria që kanë ushqyer për Shkollën "Skënderbej" kanë theksuar se kjo shkollë ishte e dalluar dhe një nga shkollat më të mira e më të kompletuara të Republikës, e cila u bë dhe fidanishtja e Ushtrisë Popullore. Kjo dashuri dhe ky respekt vazhdon gjatë gjithë përmbajtjes së librit. Autorët me këtë libër ia kanë arritur që-



Jemi skënderbegas

Tani jemi bërë,

Gjyshër-baballarë,

Po s'harrojmë kurrë,

Strehëzën e parë.

Strehëzën e parë,

Shkollën "Skënderbej",

Ky emër-si gjaku,

Na rrjedh nëpër dej.

Atdheu-të vegjël,

Na kishte filiza,

Po ai na rriti,

Na bëri lisa.

Dhe na bëri lisa,

Në pyll' të Lirisë,

Dhe ishim të gjithë,

Djemtë e vegjëlisë.

Djemtë e vegjëlisë,

Punëtorë e fshatarë,

Gati për betejë,

Në vijën e parë.

Plot me ideale,

Dhe me ëndërrime,

Aty more udhë,

Moj rinia ime.

Frymëzim të shenjtë,

Kishim Skënderbeun,

Në sy e në zemër,

Mbanim gjithë Atdheun.

Mbanim fushat-malet,

E gjithë Shqipërisë,

Prag i asaj shkolle,

Si pragu i shtëpisë.

Ai na përkundi,

Në djep dashurie,

Emri "Skënderbegas!",

Emër krenarie!

Për jetë të gdhendur,

E kemi në ballë,

Jemi skënderbegas,

Sa të jemi gjallë.

Po dhe kur të sosim,

Këtu rrugëtimet,

Kur ne të mos jemi,

Do të jenë kujtimet!

sues, artistë, shkrimtarë, shkencëtarë, sportistë, ku mund të shprehesh me plot gojë se janë ingranuar në të gjithë arteriet e Atdheut. Kjo shkollë i edukoi si qytetarë të ndershëm të Republikës.

Libri vë në dukje se në tërë vepërimitarinë e saj shkolla kishte një trupë pedagogjike e komanduese të nivelit të lartë. Mësues dhe oficerë ishin shumë të përgatitur, kërkues, këmbëngulës dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrës. Shumica e tyre ishin të diplomuar jashtë shtetit në perëndim, Itali, Gjermani, Austri dhe më vonë në ish-BS.

Të pajisur me njohuri, të gjera shkencore, trupa pedagogjike bënte përpjekje të vazhdueshme, që dijet e fituara t'u jepnin me devotshmëri e përkushtim çdo skënderbegasi. Mësuesit dhe kuadrot ushtarakë, i gjeje pranë skënderbegasve nga mëngjesi në mbrëmje.

Në libër përshkruhen mësuesit dhe kuadrot ushtarakë për skënderbegasit, ishin shembull frymëzimi, njerëz,

"prindër" me zemër të madhe, me ndjenja të thella qytetare, që rrezatonin mirësi për ta. Ishte merita e trupës pedagogjike dhe e kuadrit ushtarakë, të cilët i pritën me krahë hapur dhe u krijuan një mjedis të ngrohtë familjar. Ishte ky kuadër dhe këta mësues që pas kaq e kaq vitesh përsëri skënderbegasit, edhe gjyshër sot, shqiptojnë me nderim dhe respekt emrin "mësues", që pas prindit, ishte më bujar dhe më i ëmbli.

Meritë kanë dhe kuadrot e mësuesit e përkushtuar të kësaj shkolle si Stavri Angjeli drejtori i shkollës, Luto Haxhiu komandant i shkollës, Drita Hajro, Gjylyzare Çiço, Leonora Duka, Arsino Sina, Sadete Bajraktari, Flutra Xoxe, Shpresa Shehu, Violeta Merdani (Byliku), Eleni Luka, Marie Nano, Ali Neviri, Viron Tane, Viron Pollo, Filip Tola, Muharem Pinderi, Dilaver Dilaveri, Petraq Ikonomi, Lllazar Breshtanaku, Gaqo Dilo, Irakli Kasneci, Kastriot Papakostandini, Viron Cinxo, Perikli Jorgoni, Rinush Idrizi, Gjergj Harxhi, Agron Babamusta dhe kuadrot ushtarakë si Mark Kovaç, Riza Zeraliu, Isuf Alibejsi, Shyqyri Malaj, Baçi Braka, Ndue Lleshi, Ismet Varfi, Rami Sadushi, Et'hem Ibrahim, Hasan Gjata, Refik Kuca, Muhamet Ormeni, Eqber Skëndi etj. Ishte një brez i mrekullueshëm mësuesish dhe edukatorësh që i ushqyen, brumosën me ide, i formuan dhe i edukuan për të jetuar dhe punuar në të katër anët e atdheut, me ndjenjë të lartë përgjegjësie, me përkushtim e devotshmëri të madhe ndaj popullit dhe atdheut.

Thënia fisnike e Koto Hoxhit kishte zënë vend tek mësuesit se "nuk mbillnin krip, që s'mbin, por mbillnin farë e cila mbin". Fara që mbollën mbiu dhe mbuloi e lulëzoi në të gjitha, fushat, malet e kodrat e atdheut. Prandaj, mësuesit dhe kuadrot janë gjithmonë në çdo përvjetor të shkollës dhe të veprimtarive, duke përfaqësuar brezin e artë të arsimtarëve për të cilët edhe autorët i kanë përshkruar me finikëri, për përkushtimin e palodhur



limit të theksojnë dhe të propagandojnë se meritë të madhe në përgatitjen me cilësi të programeve, dhanë kuadrot, oficerë e mësues të shkollës. Nxënësit e saj përvetësuan programet mësimore, stërvitjen ushtarake, dhe morën pjesë në

aksionet e ndryshme kombëtare në ndërtimin e vendit. Skënderbegasit rrezatuan në të gjitha anët e Shqipërisë si oficerë: këmbësorë, pilotë, marinarë, tankistë, artilierë, xhenierë, ndërlidhës, topografë, mjekë etj. Shumë nga skënderbegasit u bënë më-

ndaj detyrës simbol të edukimit dhe të arsimimit të skënderbegasve.

Në mjediset e shkollës kurdoherë tregohej një kujdes i veçantë që skënderbegasve t’u krijoheshin të gjitha kushtet e mundshme për studim e stërvitje. Të bashkuar si një trup i vetëm mësues, kuadro, punonjës të shërbimit dhe skënderbegas mësonin dhe punonin për një qëllim, për t’i dhënë nder e dinjitet shkollës, popullaritet e personalitet para popullit. Pas kaq vitesh, e tanimë që nuk e kemi një shkollë të tillë, autorët me të drejtë e kanë vënë theksin se edhe pas kaq shumë vitesh, Shkolla “Skënderbej” u bë burimi kryesor i furnizimit të shkollave ushtarake në vend. Shkolla kishte si mision përgatitjen e nxënësve me kulturë të përgjithshme ushtarake, duke vënë në themel të programit mësimor lëndët kryesore të arsimit të përgjithshëm, për t’u hapur dyert jo vetëm për shkollat ushtarake, por edhe për universitetin shtetëror.

Kështu, nga viti 1968 e deri në mbyllje, maturantët që mbaronin me rezultate të larta në mësimet, ndiqnin studimet në Universitetin e Tiranës. Koha ka treguar se kuadrot që dolën nga kjo shkollë e kanë justifikuar plotësisht shërbimin e detyrës në mbrojtje të Atdheut.

Skënderbegasit dhe shkolla, krijuan një traditë të shkëlqyer në përgatitjen e kuadrove, kjo ka lënë gjurmë në ushtrinë tonë. Me programin

e saj mundësoi përgatitjen e oficerit të edukuar, të disiplinuar, të aftë dhe me botëkuptim atdhetar, në shërbim të atdheut e popullit. Kjo aksiomë u vërtetua në vitet ‘90 të shek. XX, kur në kohën e transformimeve të thella, të ndryshmit të sistemit shoqëror, gjatë këtij procesi spikati figura e oficerit qytetar, korrekt, besnik ndaj popullit dhe vendit, e që përkrahu proceset demokratike në vend.

‘Skënderbegasit’ që lanë gjurmë në historinë e vlerave kombëtare.

“Heroi i Popullit” Abdyl Bakiu, komandanti i parë i shkollës Ushtarake “Skënderbej”

Abdyl Bakiu u lind në Kuç të Vlorës në vitin 1911. Që në moshë të re, i mbryjtur me traditat atdhetare e familjare të zonës nga vinte, formoi një personalitet të qëndrueshëm dhe falë intelektit e zgjuarsisë natyrale, shumë shpejt, ndonëse në moshë shumë të re, u bë pjesë e pleqësisë në fshat.

Në vitin 1942, ashtu si shumë atdhetarë të zonës, ai u lidh me çetën partizane “Avni Rustemi”, ku u bë pjesëtar e një nga luftëtarët e drejtuesit aktiv të saj. Më vonë, në zjarrin e luftës për liri, ai u evidentua si një drejtues tepër i aftë e trim, ndaj ngjiti shkallët e karrierës në repartet partizane që luftonin kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit. Kështu, Abdyli emërohet komisar batalioni në Brigadën

e 6-të Sulmuese. Në drejtimin e kësaj brigade, veçanërisht në luftën për çlirim e Shkodrës, Kontributi i Abdylit si luftëtar e drejtues është shënuar dhe në beteja të tjera gjatë kohës së luftës: si aksioni për çlirimin e nënprefekturës së krahinës së Kurveleshit, që për nga hartimi i operacionit e deri tek realizimi i tij, mbetet një nga aksionet model të zhvilluar në krahinë e më gjerë.

Gjatë luftës, forcat e organizuara të Kurveleshit të Poshtëm, nën drejtimin e Abdyl Bakiut dhe Ali Lalës, në bashkëpunim me forcat partizane që komandoreshin nga Mustafa Matohiti e Ago Çeli, në mbrëmjen e 27 Nëntorit 1942, u gjendën bashkë në rrethimin e nënprefekturës ku ishin 150 xhandarë, milicë dhe ushtarë. Për të evituar vëllavrasjen, drejtuesit e operacionit i dhanë ultimatum nënprefektit që të dorëzohej Në orën e caktuar, nënprefekti u detyrua të pranonte ultimatumin e komandës partizane dhe u dorëzuan. Duke ulur tytat e armëve poshtë, e me kokulur, ata u lanë të lirë dhe u larguan në drejtimin Nivicë-Salari-Tepelenë. Kështu, populli festoi i lirë 28 nëntorin, Ditën e Pavarësisë.

Me çlirimin e vendit dhe me hapjen e shkollës ushtarake “Skënderbej”, Abdyl Bakiu, emërohet komandant i saj. Në vitin 1949, Abdyli është ndër kuadrot e parë që dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik. Studimet i mbaron në vitin 1952 dhe kthehet në atdhe. Pas kthimit, emërohet si titullar në një drejtori të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 1966 Abdyl del në pension dhe shkon vullnetarisht në fshatin e lindjes për të dhënë kontributin e tij. Në fillim ai emërohet kryetar i lokalitetit, ku spikasin aftësitë e tij drejtuese e organizuese, përballë problemeve të shumta, që kishte populli në ato vite të vështira.

Përveç kryerjes me përgjegjësi të gjithë detyrave të ngarkuara, Abdyli ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm dhe në aspekte të tjera si në ngritjen e muzeut të fshatit, ndërtimin e mirëmbajtjes e varrezave të fshatit, në ndërtimin e shtëpisë së kulturës e mbarëvajtjes së aktiviteteve, etj...

Gjatë kohës që ishte në ushtri, ashtu dhe gjatë viteve kur ishte funksionar në pushtetin lokal, Abdyli është zgjedhur deputet dhe ka përfaqësuar zonën në disa legjislatura në Kuvendin e Shqipërisë.

IN MEMORIUM



NJË VIT PA GJENERAL NDRIÇIM SALLAKUN

“Lamtumirë mik i mirë”

Një vit pa gjeneral Ndriçim Sallakun, pa kolegun e përkushtuar, mikun e kudogjendur, shokun e dashur, bashkëshortin dhe babanë model!

Shumë dhimbje e trishtim për ndarjen e parakohshme nga jeta të gjeneral Brigade Ndriçim Sallakut, profesionistit të përkushtuar të Forcave të Armatosura.

Përmbi tre dekada angazhim në ushtrinë shqiptare, ai shërbeu si rralëkush nën uniformë, duke spikatur për aftësitë e Tij drejtuese dhe organizative, ku dëshmoi gjithashtu vlera të larta humanizmi dhe bashkëpunimi siç dinte veç ai.

Usharak karriere, ai realizoi me sukses çdo detyrë të ngarkuar, ku disa prej të cilave ishin:

Gjeneral Brigade Komandant i Komandës Mbështetëse, Atashe Usharak i RSH në Republikën e Turqisë, Drejtor i Shtabit të përgjithshëm të FA-së; Komandant, Drejtor, Oficer shtabi për stërvitjen, Përgjegjës Sektori, Planifikim Koordinim, Zv. Drejtor i Drejtorisë Logjistike, Me mision në Gjeorgji, Oficer Shtabi për Infrastrukturën, Komandant i Akademisë së Nënoficerëve “Thomson”, Specialist për Shërbimet Intendente, Specialist Planëzimi Logjistik, Shef Shërbimi Ushqimi, Drejtor Logjistike, Drejtor i Drejtorisë së Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, Oficer Shtabi për Stërvitjen në Shtabin e LANDCOM të NATO-s, Izmir, Turqi, Komandant i Batalionit të Transportit, në Brigadën Logjistike, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Logjistik, në J4 në SHP të FA-së, Shef Logjistike.

Jeta është kalimtare dhe ndonjëherë e ndërprerë. Gjeneral Ndriçimi humbi betejën për jetën duke na shkaktuar të gjithëve, familjes, kolegëve, miqve, një humbje të pazëvendësueshme.

Shumë kolegë tanë, të rinj dhe jo vetëm, mësuan prej tij bazat e mjeshtërisë dhe shpesh përdornin këshillat dhe ndihmën e tij. Ai ishte i durueshëm dhe i përgjegjshëm, gjithmonë dëgjonte ata që i drejtoheshin për mbështetje, të jepte këshilla, të ndihmonte, kurrë nuk refuzoi kërkesat e askujt. Ai mund të gëzonte në mënyrë të shkëlqyer këdo që ishte i mërzitur, ose i dëshpëruar. Historitë e panumërta me sens humori, që ai tregonte në tryeza mes miqsh, do të mbeten të paharruara. Do të na mungojë të gjithëve. Ai do të mbetet në memorien tonë dhe të gjithë kolegëve tanë si shembull i këmbënguljes, gazit vezullues, aktivitetit dhe profesionalizmit!

Luftoi aq shumë për jetën, ku prej vitesh me radhë fitoi disa beteja, por nuk ia doli dot t’i shpëtonte përballjes së fundit, duke lënë mes nesh kujtimin e një njeriu që guxonte të ishte vetvetja, të ishte i vërtetë, i guximshëm dhe përherë aktiv për të ruajtur frymën e bashkëjetesës dhe solidaritetit.

Do i mungosh përjetësisht Majlindës, bashkëdhëtares të jetës tënde, fëmijëve, Klezias, Mandrit, Ejonës...

Ne shokëve, miqve dhe kolegëve.

Sa shumë e doje gazin-harenë dhe pa vijë melodike, por me fjalë zemre po të kujtojmë në këtë vit larg nesh.

“E ç’mund t’i shtojmë ne

Që s’na mbetet tjetër gjë

Veçse të admirojmë?

Ti... kujtimi ynë më i bukur.

Një faqe e denjë në librin e brezave” (Majlinda)

Të qoftë i lehtë dheu në gjoks miku ynë!

Leonard Musollari





Shkëmbim eksperiencash mes studentëve të FA dhe "West Point"

Dy studentët amerikanë nga Akademia Ushtarake e SHBA-së "West Point", Sarah E. Traynor dhe Sebastien L. Morel, në kuadër të programit "West Point Exchange", gjatë muajit mars, qëndruan dhe shkëmbyen eksperiencën e tyre me studentët tanë të programit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Ushtarake, Viti II.

Studentët amerikanë u integruan shpejt me kolegët e tyre shqiptarë, duke u aktivizuar edhe në rolin e drejtuesit të togës gjatë zhvillimit të taktikës në tema të ndryshme të saj.

Ata gjithashtu patën rastin të provonin mikpritjen dhe bujarinë e kolegëve të tyre nëpërmjet vizitave kulturore dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare në Apolloni, Vlorë dhe Tiranë. Së shpejti, dy studentë shqiptarë do t'ua kthejnë vizitën në shtëpinë e tyre në Akademinë Ushtarake të SHBA-së "West Point".



Ekipi i AFA-së, pjesë e aktivitetit sportiv ndërkombëtar "Trail Running Petrela" të organizuar nga Bashkia Tiranë

Ekipi i AFA-së mori pjesë në aktivitetin sportiv ndërkombëtar "Trail Running Petrela" të organizuar nga Bashkia Tiranë. Gara kishte dy disiplina 10 km dhe 21 km. Ky ekip përbëhej nga studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit bachelor 15 veta dhe pjesarë të stafit të AFA-së, Major Bleart Vucaj, Kapiten Endri Deda si dhe kursant i KKSHP - së Major Bledar Mesi. Ekipi i AFA doli më i mirë nga pjesmarrja duke i dhënë tonin aktivitetit dhe duke treguar shpirt të lartë gare. Shefi i Departamentit të Formimit Ushtarak Kolonel Elton Bregu, i uroi studentët për pjesmarrjen dhe performancën e lartë fizike. Në fund të aktivitetit u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve ku ishin prezent, Kryetari i Bashkisë zoti Erjon Veliaj si dhe përfaqësues të Sportit. Major Bledar Mesi zuri vendin e dytë në garën e 10 km.



Kolonel Toska: Arsimimi sa më cilësor rrit nivelin e performancës si ushtarak dhe individ në shoqëri

Përfundon Kursi i 51-të Bazë i Nënoficerit në QAPN. Në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të kursit 51-të Bazë i Nënoficerit.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN - së Kolonel Arben Toska, si dhe stafi i instruktorëve dhe mësuesit të QAPN-së.

Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i QAPN - së Kolonel Toska përshëndeti kursantët që përfunduan kursin Bazë të Nënoficerit.

Ai theksoi se: "Arsimimi dhe trajnimi sa më cilësor është thelbësor, pasi është metoda bazë e përparimit dhe reformimit social, duke rritur kështu përfaqësimin dinjitoz në nivelin e performancës si ushtarakë dhe individë në shoqëri. Arsimimi është stafeta e profesionalizmit dhe mbrojtësi më i mirë i lirisë, më i mirë sesa një armatë këmbësorie, ndaj nuk ka investim më të rëndësishëm për ne sesa investimi në arsimim dhe dije".



Në këtë kurs u certifikuan 38 nëntetarë, të ardhur nga struktura të ndryshme të Forcave të Armatosura, të cilët përfunduan kursin me sukses.



CEREMONI ME RASTIN E DALJES NË PENSION TË KOLONELIT NË REZERVË VAIT GOLIKJA

Mirënjohje për kontributin e dhënë në shërbim të atdheut, ushtarakëve tanë

Në garnizonin “Skënderbej”, në ambjentet e Muzeut të Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare Kërkim-Shpëtimit organizoi një ceremoni me rastin e daljes në pension të kolonelit në rezervë Vait Golikja, me një karrierë të gjatë mbi 40 vjet në strukturat e Ministrisë të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

Në këtë ceremoni krahas personelit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit morën pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes znj. Dallëndyshe Bici, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu, familjarë dhe të ftuar të tjerë, ushtarakë dhe ish ushtarakë.

Ceremoninë e hapi kryetari i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, kolonel Fiqiri Hoxha.

Të pranishmit i përshëndeti zëvendëshefi i Shabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj vlerësoi punën e kolonelit Golikes gjatë viteve të shërbimit si ushtarak në detyrë dhe më pas, në strukturat civile të Forcave të Armatosura.

Pas shfaqes të një video-montazhi të përgatitur nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, për punën e bërë ndër vite të kolonelit Golikes, të pranishmit i përshëndeti zv. ministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici.



Znj. Bici tha se “kolonel Golikja ka kryer detyra të shumta në Forcat e Armatosura, nga komandant toge dhe deri në detyra më të larta si shef shtabi Brigade e Divizioni, si pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, Inspektor i përgjithshëm në FT, shef i Shtabit të Komandës së Doktrinës e Stërvitjes, komandant i QBO-së, këshilltar i Ministrit të Mbrojtjes etj”.

Zëvendësministria Bici tha midis të tjerash se “eksperiencën e vet në detyra të ndryshme e të shumta, koloneli e vuri në shërbim të Forcave të Arma-

tosura edhe për një periudhë 10-vjeçare si punonjës civil në disa institucione të rëndësishme si Qendra e Analizave të Mbrojtjes, Qendra e Doktrinave e Manualeve, Qendra e Bashkuar Operacionale, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit nga ku po del edhe sot në pension”, - tha ajo.

Zëvendësministria e Mbrojtjes i dha kolonelit Vait Golikes, me rastin e daljes së tij në pension “Medaljen e Mirënjohjes”, akorduar nga Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.

Në qendrën stërvitore të Forcës Ajrore filluan kurset bazë dhe të avancuara të nënoficerit

Në qendrën stërvitore të Forcës Ajrore me venddislokim në bazën Ajrore Kuçovë filluan kurset bazë dhe të avancuara të nënoficerit të Forcës Ajrore, faza e II.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, mori pjesë komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefi i qendrës stërvitore të Forcës Ajrore kolonel Adrian Kuli, komandanti i bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Olldashi, këshilltar i Forcës Ajrore kapter Aida Guxha si dhe instruktorë e kursantë të kursit të sapofilluar.

Në fjalën e hapjes, shefi i qendrës stërvitore falënderoi komandantin e Forcës Ajrore për pjesëmarrjen, si dhe informoi mbi programin, objektivat dhe synimet e këtyre kurseve.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj



përshëndeti trupën e kursantëve dhe instruktorëve duke uruar për fillimin e kurseve si dhe theksoi rëndësinë e kualifikimeve të trupës së nënoficerëve si për përparimin në karrierë por edhe për vijimin e kontributit më tej në përballimin e sfidave në kuadër të zhvillimeve të pritshme në Forcën Ajrore.

Komandanti vlerësoi gjithashtu rolin që ka nënoficeri i Forcës Ajrore në të gjitha nivelet e komandimit, duke marrë më shumë përgjegjësi dhe pozicione drejtuese, arritje të cilat bazohen në punë, kualifikim të vazhdueshëm dhe angazhim cilësor. Në fund të fjalës së tij, gjeneral Pulaj i uroi mbarësi trupës së nënoficerëve dhe instruktorëve në përmbushjen e objektivave të përbashkëta.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S VIZITON STËRVITJEN “REAGIMI I FTOHTË” NË NORVEGJI

Stoltenberg: Veriu i Lartë, një zonë me rëndësi kritike për të gjithë aleatët

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg ishte në Bardufoss, Norvegji, për të vizituar “Cold Response”, një stërvitje e udhëhequr nga Norvegjia me pjesëmarrjen e 27 aleatëve dhe partnerëve të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm u takua me trupat pjesëmarrëse në stërvitjen “Përgjigjja e Ftohtë” në Norvegjinë veriore. Sekretari i Përgjithshëm tha se “Reagimi i ftohtë” tregon unitet dhe forcën e NATO-s në veprim, me forcat nga Evropa dhe Amerika e Veriut që stërviten së bashku.

30 000 personel po marrin pjesë në stërvitjen e udhëhequr nga Norvegjia, duke përfshirë partnerët më të ngushtë të NATO-s, Finlandën dhe Suedinë. Janë vendosur gjithashtu 220 avionë, si dhe 50 anije, duke përfshirë dy grupe aeroplanmbajtëse nga Mbretëria e Bashkuar dhe Italia.

Z. Stoltenberg tha se “Veriu i Lartë” është një rajon me rëndësi strategjike për NATO-n dhe se vitet e fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të aktivitetit ushtarak rus në rajon. Ai nënvizoi se prania e NATO-s në zonë nuk është për të provokuar një konflikt, por për të parandaluar konfliktin dhe për të ruajtur paqen. Sekretari i Përgjithshëm tha se “Reagimi i ftohtë” demonstron aftësinë e NATO-s për t’u mbrojtur kundër çdo kërcënimi, nga çdo drejtim. Kjo tregon se si Aleanca mund të vendosë një numër të madh forcash në “Veriun e Lartë” dhe ndërkohë që dërgon trupa në Evropën Lindore, si pjesë e përgjigjes së NATO-s ndaj pushtimit rus të Ukrainës.

Sekretari i Përgjithshëm shpjegoi se “Reagimi i ftohtë” është një stërvitje mbrojtëse dhe e planifikuar prej kohësh. Norvegjia ftoi të 57 anëtarët e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë për të vëzhguar stërvitjen, por Rusia e refuzoi atë ftesë.

Konferencë për shtyp nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në Bardufoss, Norvegji për stërvitjen “Reagimi i ftohtë”

“Është mirë të kthehesh në Bardu-



foss, për të takuar forcat që marrin pjesë në stërvitjen e “Reagimit të Ftohtë”. Një javë më parë, katër marins amerikanë humbën jetën në një aksident tragjik avioni. Më lejoni të filloj duke shprehur ngushëllimet e mia më të thella për familjet dhe të dashurit e tyre dhe për të gjithë shokët e tyre ushtarë që qëndrojnë së bashku për të mbrojtur territorin e NATO-s.

Dua të falënderoj Norvegjinë për udhëheqjen e kësaj stërvitjeje të rëndësishme. “Përgjigjja e Ftohtë” tregon unitetin dhe forcën e NATO-s në veprim. Ka 30 000 personel nga 27 vende që marrin pjesë, përfshirë partnerët më të afërt të NATO-s, Finlandën dhe Suedinë. Ne kemi vendosur 220 avionë, duke përfshirë avionë luftarakë të gjenaratës së pestë dhe më shumë se 50 anije, përfshirë dy grupe aeroplanmba-

jtëse nga Mbretëria e Bashkuar dhe Italia. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës është një moment vendimtar. Është një normalitet i ri për sigurinë evropiane dhe gjithashtu për sigurinë e Arktikut.

NATO është një Aleancë Arktike. 4 nga 5 shtetet bregdetare të Arktikut janë vende të NATO-s. Është një rajon me rëndësi strategjike për sigurinë e të gjithë zonës euroatlantike dhe kritike për lidhjet e komunikimit midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Është gjithashtu një rajon i konkurrencës strategjike në rritje.

Në vitet e fundit, ne kemi parë një rritje të konsiderueshme të aktivitetit ushtarak rus këtu. Rusia ka rivendosur bazat Arktike të epokës sovjetike. Ky është një shtrat provë për shumë nga sistemet e reja të armëve të Rusisë. Është shtëpia e flotës strategjike të

nëndetëseve ruse. Ngritja ushtarake e Rusisë është sfida më serioze për stabilitetin dhe sigurinë aleate në “Veriun e Lartë”. Ne shohim gjithashtu një interes të shtuar kinez në rajon. Kina e ka përcaktuar veten si një shtet “afër Arktikut” dhe synon të krijojë një prani këtu.

Për të gjitha këto arsye, “Veriu i Lartë” është një zonë me rëndësi kritike për të gjithë aleatët. Kjo është arsyeja pse aleatët e NATO-s kanë rritur prania të tyre ushtarake në veri dhe kjo stërvitje është një shembull i kësaj. Më shumë do të kërkohet në të ardhmen. Një prani e fortë, e qëndrueshme dhe e parashikueshme e Aleatëve është mënyra më e mirë për të siguruar stabilitet dhe për të mbrojtur interesat tona. Ne nuk mund të përballojmë një vakum sigurie në “Veriun e Lartë”, mund

të nxisë ambicet ruse, të ekspozojë NATO-n dhe të rrezikojë llogaritjet e gabuara dhe keqkuptimet.

Gjatë viteve të fundit, NATO është rritur. Krijoi një komandë të re të NATO-s për Atlantikun, ushtrohet më shpesh, me dy stërvitjet më të mëdha që nga Lufta e Ftohtë të mbajtura në këtë rajon. Aleatët si SHBA, Britania e Madhe dhe Norvegjia kanë investuar më shumë në aftësitë më të avancuara, duke shfaqur prani më të madhe në det dhe në ajër. Dhe ne monitorojmë nga afër zhvillimet në rajon dhe ndajmë informacione.

Prania e NATO-s nuk është për të provokuar një konflikt, por për të parandaluar konfliktin dhe për të ruajtur paqen. “Reagimi i ftohtë” është një stërvitje vendimtare. Ai demonstron aftësinë e NATO-s për t’u mbrojtur kundër çdo kërcënimi, nga çdo drejtim.

Ne jemi të hapur dhe transparent, siç jemi me të gjitha stërvitjet tona. Norvegjia ftoi të 57 anëtarët e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë që të vëzhgojnë “Reagimin e Ftohtë”. Por Rusia e refuzoi atë ftesë. Në këtë moment të rrezikshëm për sigurinë tonë, është edhe më e rëndësishme që ne të ushtrojmë gatishmërinë e forcave tona dhe kapacitetin tonë për të përforcuar trupat tona përtej Atlantikut. Në Samitin e NATO-s dje, aleatët ranë dakord të vazhdojnë të imponojnë kosto ndaj Rusisë dhe të mbështesin më tej partnerin tonë të ngushtë Ukrainën, me furnizime ushtarake shtesë, si dhe ndihma të konsiderueshme financiare dhe humanitare.

Ne gjithashtu vendosëm të fillonim rivendosjen e mbrojtjes dhe parandalimit tonë. Hapi i parë është vendosja e katër grupeve të reja betejë në lindje të Aleancës sonë dhe unë pres që udhëheqësit e NATO-s të bien dakord për hapat e mëtejshëm në Samitin tonë të ardhshëm në qershor, për të mbajtur njerëzit tanë të sigurt.

SIGURIA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Komiteti Ushtarak i NATO-s dhe BE-së takohen në format të përbashkët

Komiteti Ushtarak i NATO-s priti Komitetin Ushtarak të Bashkimit Evropian për një takim të përbashkët për të diskutuar situatën aktuale të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, angazhimin aktual në Bosnje dhe Hercegovinë si dhe operacionin “Althea” në vazhdim të BE-së.

Në hapje të takimit, zëvendëskryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, gjenerallejtënant Lance Landrum mirëpriti përfaqësuesit ushtarakë të NATO-s dhe BE-së, si dhe Kryetarin e Komitetit Ushtarak të BE-së, gjeneralin Claudio Graziano. Ai ritheksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit NATO-BE në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në kohë krize. “Bashkëpunimi ynë i vazhdueshëm është thelbësor për arritjen e përparimit thelbësor dhe të qëndrueshëm, jo vetëm në Bosnje dhe Hercegovinë, por në të gjithë Ballkanin Perëndimor, por edhe për të mbrojtur dhe promovuar lirinë, demokracinë dhe vlerat tona të përbashkëta”, - shtoi ai.

Më pas, Përfaqësuesi Ushtarak i NATO-s dhe BE-së mori një përditësim mbi aktivitetet e vazhdueshme politike në lidhje me aktivitetin e BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, zhvillimet e fundit në rajon si dhe përditësimet e statusit të aktiviteve përkatëse të NATO-s dhe BE-së në vend. “Siguria dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor është i rëndësishëm për NATO-n dhe për paqen dhe stabilitetin në Evropë.

NATO dhe BE punojnë për të promovuar stabilitetin, sigurinë dhe bashkëpunimin në rajon – dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë”, - theksoi gjenerallejtënant Landrum.

Informatat e radhës u bënë nga komandanti i shtabit të NATO-s në Sarajevë (NHQSA), gjeneral brigade Pamela McGaha dhe komandanti i EUFOR-it, gjeneralmajor Anton Wessely, përkatësisht mbi aktivitetet e vazhdueshme të NHQSA dhe operacionin “Althea” të BE-së. Pas përfundimit të misionit të NATO-s, SFOR në 2004, BE-ja vendosi operacionin e saj “Althea”. Aleanca ofron mbështetjen planifikuese, logjistike dhe komanduese për misionin e BE-së, në kuadër të një pakete marrëveshjeje të njohur si “Berlin Plus”. Këto marrëveshje ofrojnë kuadrin e përgjithshëm për bashkëpunimin NATO-BE.

Takimi i sotëm ishte takimi i fundit i përbashkët i Komitetit Ushtarak NATO-BE nën kryesimin e gjeneralit Graziano, i cili mori postin në nëntor 2008, si i tillë, gjenerallejtënant Landrum përfundoi seancën duke theksuar përkushtimin dhe angazhimin shembullor të gjeneralit Graziano dhe përgëzoi avokimin e vazhdueshëm të tij për bashkëpunim të zgjeruar ndërmjet NATO-s dhe BE-së.



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S PREZANTON RAPORTIN E TIJ VJETOR PËR VITIN 2021

Stoltenberg: Ne u përgatitëm për më të keqen, por punuam shumë për më të mirën

Sekretari i NATO-s Jens Stoltenberg publikoi në raportin e tij vjetor për vitin 2021, i cili mbulon të gjitha aspektet e punës së Aleancës gjatë vitit të kaluar. Për Ukrainën, Stoltenberg tha se NATO kishte paralajmëruar vazhdimisht se Rusia ishte e gatshme të nisë një pushtim të plotë të Ukrainës: “Ne u përgatitëm për më të keqen, por punuam shumë për më të mirën. Ne bëmë çdo përpjekje për të angazhuar Rusinë në dialog, por Moska vazhdimisht na refuzoi dhe në fund vendosi të ndërpresë lidhjet diplomatike. Vjeshtën e kaluar, ne gjithashtu ndërmorëm veprime për të rritur gatishmërinë e forcave tona, për të vendosur më shumë trupa në pjesën lindore të Aleancës sonë dhe për të rritur mbështetjen tonë për Ukrainën”.

Sekretari i Përgjithshëm shpjegoi se mbështetja afatgjatë e

NATO-s për Ukrainën kishte nënkuptuar që forcat ukrainase tani janë më të mëdha, më të pajisura, më të trajnuara dhe të udhëhequra më mirë se kurrë më parë. Ai tha se Rusia tani po përpaketet të rigrupohet, të rifurnizohet dhe të përforcojë ofensivën e saj në rajonin e Donbasit. Stoltenberg tha: “Rusia duhet t’i japë fund kësaj lufte të pakuptimtë, të tërheqë të gjitha trupat e saj dhe të përfshihet në bisedime me mirëbesim”. Stoltenberg tha se vitet e punës së NATO-s për të forcuar Aleancën nënkuptonin se NATO ishte përgjigjur shpejt dhe me vendosmëri për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Ai kujtoi se në vitin 2021, dy selitë më të reja të përbashkëta të NATO-s u bënë plotësisht funksionale dhe se forcat aleate mbetën të gatshme dhe vigjilente, me misionet dhe dislokime nga rajoni i Balltikut në Irak.

Në lidhje me tërheqjen e vitit të kaluar të Misionit të Mbështetjes Vendimtare nga Afganistani, Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se aleatët arritën të evakuojnë më shumë se 120 000 njerëz gjatë tre javëve dhe se rreth 2 000 afganë që kishin punuar për NATO-n tani janë zhvendosur në vendet aleate. Ai tha: “Mësimet që kemi nxjerrë nga Afganistani do të formësojnë përgjigjen e Aleancës ndaj krizave në të ardhmen”.

Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se 2021-shi ishte viti i shtatë radhazi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë aleatët evropianë dhe Kanada, duke arritur në një rritje prej 3.1% në terma realë dhe një total prej 270 miliardë dollarë shtesë që nga viti 2014.

18 VJET ANËTARËSIM NË NATO

Stoltenberg: Kontributet e Bullgarisë janë edhe më të rëndësishme në këtë moment përcaktues për sigurinë tonë

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kontributin e Bullgarisë në NATO në 18-vjetorin e anëtarësimit të saj. Në një mesazh drejtuar Asamblesë Kombëtare Bullgare, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg vlerësoi kontributet e Bullgarisë për sigurinë e përbashkët dhe konfirmoi angazhimin e NATO-s për mbrojtjen e të gjithë aleatëve. Anëtarësimi i Bullgarisë në NATO që prej 29 marsit 2004 e ka bërë atë më të sigurt, ka çimentuar më tej demokracinë dhe lirinë në Evropë dhe e ka bërë NATO-n edhe më të fortë, tha zoti Stoltenberg.

Video-mesazh nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në Asamblenë e 47-të Kombëtare të Parlamentit Bullgar me rastin e 18-vjetorit të anëtarësimit në NATO.

“Shumë urime për përvjetorin e anëtarësimit të Bullgarisë në NATO!

Tetëmbëdhjetë vjet më parë sot, vendi juaj u bashkua me Aleancën tonë dhe Bullgaria ka qenë një aleat i përkushtuar që atëherë. Unë jam mirënjohës për kontributin e Bullgarisë në sigurinë tonë të përbashkët. Jo më pak në rajonin e Detit të Zi, i cili ka një rëndësi të madhe strategjike për NATO-n, ku ju ofroni aftësi të rëndësishme, duke përfshirë anijet për patrullat e NATO-s.

Bullgaria gjithashtu ndihmon në ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, duke kontribuar në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë. Ju pritët një njësi për integrimin e forcave në Sofje, si pjesë e “Pranisë Përpara” të NATO-s. Kjo njësi përfaqëson një prani të dukshme dhe të vazhdueshme të NATO-s në vendin tuaj. Kontributet e Bullgarisë janë edhe më të rëndësishme në këtë moment përcaktues për sigurinë tonë.

Lufta e Presidentit Putin në Ukrainë po shkakton vdekje dhe shkatërrim çdo ditë, duke kërcënuar sigurinë e Evropës dhe duke sfiduar të gjithë rendin ndërkombëtar.

Aleatët e NATO-s e dënojnë këtë luftë dhe i bëjnë thirrje Presidentit Putin që ta ndalojë atë menjëherë, të tërheqë të gjitha forcat e tij! Të angazhohet në diplomaci!

Aleatët e NATO-s po i imponojnë Rusisë kosto të paprecedentë. Kemi rritur ndjeshëm mbështetjen tonë për Ukrainën, përfshirë sasi të mëdha pajisjesh antitank dhe antiraketë për të ndihmuar në shpëtimin e jetëve të Ukrainës. Bullgaria ka dërguar ndihma humanitare në Ukrainë, përfshirë pajisjet e strehimit dhe furnizimet mjekësore dhe ju keni pranuar refugjatë ukrainas.

Në përgjigje të këtij realiteti të ri, NATO po rrit parandalimin dhe mbrojtjen e saj. Tani janë qindra mijëra forca në gatishmëri të shtuar në të gjithë Aleancën. Njëqind mijë trupa amerikane në Evropë dhe rreth 40 000 trupa nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s,

kryesisht në pjesën lindore të Aleancës, mbështetur nga fuqia e madhe ajrore dhe detare, si dhe mbrojtjet ajrore.

Aleatët kanë dërguar trupa në Bullgari. Spanja ka dërguar avionë Eurofighter dhe Holanda së shpejti do të dërgojë F-35, duke punuar krah për krah me forcat ajrore bullgare. Ju po krijoni një grup të ri beteje shumëkombëshe të NATO-s. Ky është solidariteti transatlantik në veprim. Ai dërgon një

mesazh të pagabueshëm se ne jemi të gjithë së bashku. Ne do ta mbrojmë Bullgarinë dhe mbrojmë çdo centimetër të territorit aleat. Një për të gjithë dhe të gjithë për një.

Prania jonë e shtuar është mbrojtëse, për të mos provokuar një konflikt, por për të parandaluar një konflikt. Për të ruajtur paqen. Në këtë botë më të rrezikshme, ne nuk mund ta marrim paqen si të mirëqenë. Pra, ne duhet të

investojmë edhe më shumë në mbrojtje, për të mbajtur kombet tona të sigurta. Buxhetet e mbrojtjes në të gjithë NATO-n janë rritur për shtatë vjet rresht dhe ne duhet të vazhdojmë këtë moment. Kështu që unë inkurajoj Bullgarinë dhe të gjithë aleatët që të investojnë një minimum prej 2% të PBB-së në mbrojtje. Më shumë se dy dekada më parë, Bullgaria zgjodhi lirisht të ecte në rrugën euro-atlantike dhe u anëtarësua në NATO. Më 29

mars 2004, ju u bëtë zyrtarisht anëtar. Kjo e ka bërë vendin tuaj më të sigurt. Ajo ka çimentuar më tej demokracinë dhe lirinë në të gjithë Evropën dhe kjo e ka bërë Aleancën tonë edhe më të fortë. E di që mund të mbështetem në angazhimin e vazhdueshëm të Bullgarisë ndaj NATO-s në të ardhmen. Urime sërish për këtë përvjetor dhe faleminderit shumë për gjithçka që bëni për sigurinë tonë të përbashkët”.

Koncepti i ardhshëm Strategjik i NATO-s

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm diskuton rolin në zhvillim të NATO-s në stabilitetin global

Zv. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană, diskutoi se si NATO po përshtatet me një botë më të rrezikshme dhe konkurruese në një fjalim në Pragë “Jemi në pikën e kthesës historike ku përballemi me një luftë më themelore për vlerat dhe mënyrën tonë të jetesës. Liria mbi shtypjen, demokracia mbi autokracinë dhe sundimi i ligjit mbi sundimin e forcës brutale. Ne duhet t’i përshtatemi këtij realiteti të ri global dhe jemi të tillë.”, tha zoti Geoană. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm përshkroi përgjigjen e shpejtë dhe të unifikuar të NATO-s ndaj pushtimit të paprovuksuar të Ukrainës nga Rusia dhe masat që Aleanca po merr për të mbështetur partnerët e saj dhe për të forcuar qëndrimin e saj në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese. Z. Geoană foli në një aktivitet të bashkëorganizuar nga Republika Çeke, Kanadaja, Danimarka, Estonia, Franca dhe Norvegjia. Ky ishte i fundit nga katër seminarët e organizuara nga Aleatët mbi Konceptin e ardhshëm Strategjik të NATO-s, i cili do të miratohet nga udhëheqësit e Aleatëve në Samitin e Madridit në qershor.



PËRGJIGJE NDAJ KORONAVIRUSIT

Iraku përfiton nga mbështetja e vazhdueshme e NATO-s

Iraku mori më shumë se 1 ton pajisje elektrike të specializuara dhe një paketë mjedesh mirëmbajtjeje nga Fondi i Përgjigjes ndaj Pandemisë së NATO-s, me transport ajror të siguruar nga Italia. Kjo dërgesë vijon me sistemin e gjenerimit të oksigjenit dhe 100 bombola oksigjeni të dhuruara vitin e kaluar dhe shënon përfundimin e projektit të Fondit të Mirëbesimit për Reagimin Pandemik në mbështetje të Irakut. Kjo pajisje shtesë e konsiderueshme do të lejojë funksionalizimin e sistemit të gjenerimit të oksigjenit.

Qendra e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike e NATO-s, e cila është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin ndaj emergjencave civile, Agjencia për Mbështetjen dhe Prokurimin e NATO-s dhe Misioni i NATO-s në Irak e koordinuan këtë donacion, në përgjigje të një kërkesë të Irakut për ndihmë në lidhje me COVID-19, pandemi globale.

Pas kërkesës për mbështetje nga Qendra Euro-Atlantike e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqë-

sive, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes italiane siguruan transportin për dërgimin e pajisjeve dhe furnizimeve mjekësore në Irak. Qendra e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike, Agjencia për Mbështetjen dhe Prokurimin e NATO-s dhe Misioni i NATO-s në Irak koordinuan blerjen e pajisjeve. Delegacioni italian në NATO koordinoi transportin e të dy alokimeve të ndihmës.

Dorëzimi i pajisjeve do të pasohet nga instalimi në vend dhe trajnimi për funksionimin e saj. Pajisjet iu dorëzuan Ministrisë së Punëve të Jashtme të Irakut dhe do të rrisin kapacitetet mjekësore të Irakut për

t’u përballur me pandeminë. Disa vende donatore aleate, duke përfshirë Belgjikën, Republikën Çeke, Danimarkën, Norvegjinë, Sllovakinë dhe Turqinë e financuan projektin. Italia financoi dhe organizoi transportin për në Irak.

NATO vazhdon të ofrojë kontigjente ndihmesh në përgjigje të pandemisë së koronavirusit përmes Fondit të Mirëbesimit për Reagimin Pandemik. Që nga viti 2020, 13 vende kanë qenë përfitues të paketave të ndihmës së NATO-s për COVID-19, përmes Qendrës Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive.

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ose njerëzimi do t'i japë fund luftës, ose lufta do t'i japë fund njerëzimit

(D. Kennedy)

Lufta. Përfytyrimi i parë që na vjen në mendje, shkatërrim, armë, gjak dhe 'kasapanë' e madhe. Të gjithë e dimë që për të filluar një luftë nuk duhet shumë mundim, por për t'iu shmangur këtij konflikti është e vështirë. Lufta konceptohet si një armë.

Në vendin ku njerëzit luftojnë me gjak nuk mund të mbijë qoftë edhe një lule e jo më ajo tokë të lulëzoje nga bimët, lulet, pemët dhe të harmonizohet nga cicërimat e zogjve. Vendi ynë është përballur me shumë armiq. Ne jemi bërë pjesë e luftërave dhe e dimë se çfarë vragesh lë ajo. Lufta është uri, këpucë të grisura dhe shtëpi me erë baruti. Le të mos përsëritet kurrë lufta dhe ne do ta dimë atë nga historia "e largët?! e afërt?! aktuale?!...

Sipas tregimeve të gjyshes sime, mund të shkruaj se si kanë jetuar fëmijët gjatë luftës. Një gjë e kuptova me siguri: ata nuk kishin fëmijëri. Që në moshë të re, djemtë dhe vajzat duhej të duronin trazira të forta emocionale. Dhe fëmijët u detyruan të punonin në kopshte, të ndihmonin ushtrinë, në mënyrë që të mbijetonin disi.

E tmerrshme, e mbushur me tingujt e shpërthimeve dhe erën e barutit, thënia "fëmijët e luftës". Po, ata nuk ishin në front, por nuk duhej të luanin me kukulla dhe makina - ata u detyruan të luftonin për mbijetesë.

Gjyshja thoshte: "bijë, ushtarakët (partizanë) në atë kohë gjithmonë përpqeshin t'i trajtonin me ato thërrime buke që u ndodheshin në trastë, ose t'u jepnin një kokërr mollë a dardhë banorëve të vegjël të popullsisë. Ata shpresonin që shpirtrat e tyre të rinj, të cilët ishin të detyruar të mos shijonin fëmijërinë e tyre, por të duronin të gjitha problemet që lidhen me operacionet ushtarake, do të qetësoheshin disi mbi shpirtrat e tyre të rinj".

Unë nuk dua të shoh një luftë dhe me të vërtetë shpresoj që njerëzit të mësojnë të negociojnë pa të shtëna armësh.

Fëmijët dhe lufta

Cili i rritur, pasi kishte shkuar në luftë, do të gjente forcën për të duruar të gjitha vështirësitë e luftës? Dhe ata ishin fëmijë ... Lufta është mizore veçanërisht për fëmijët e vegjël që nuk e kishin parë ende jetën, humbën të gjitha gëzimet e fëmijërisë, lufta u ngarkoi atyre një barrë të rëndë përgjegjësie dhe detyrash.

A është lufta fataliteti i jetës njerëzore?

Mendoj se po, sepse është arma më e fuqishme që njerëzimi zotëron. Edhe pse kemi kaluar shekuj drejt një civilizimi dhe e kemi rritur standartin e qytetërimit, teknologjinë, dijen si asnjë herë në histori, përsëri njerëzimi, edhe ai evropian, moralisht duket se ka mbetur po ai, njeriu armiqësor, fisnor madje ç'njerëzor i shpellave. Ky primitivitet me instikte shtazore dhe ç'njerëzi tregohet sidomos në luftërat ku jeta e tjetrit bëhet gjëja më e pavlerë dhe ana morale e humanitetit sfumohet në absurd.

Gabimet e harruara të historisë përsëriten, sepse edhe para Luftës së Parë Botërore edhe të Dytë shumë



mendonin se Europa ishte 'shumë e civilizuar' për të hyrë në luftë, por nuk vonoi, dhe nga një shkak si vrasja e arqidukës Franc Ferdinandit të parë në Sarajevë në 1914, që përfundoi 1918 me 14 milion viktima, dhe për të dytën mjaftoi mësymja e Hitlerit në Poloni në 1940 që përfundoi 1945 me 60 milion viktima.

Mos të çuditemi për këto, sepse historia edhe pse harrohet ajo përsëritet. Europa ka qënë arena e shumë luftërave të përgjakshme dhe veçanërisht në shekullin e kaluar të dy luftërave botërore. Ajo që sot e frikëson më shumë njerëzimin nga një luftë e tretë botërore, që mund ta ketë përsëri fillues në Evropë, është fakti i frikshëm se teknologjia ushtarake ka intensifikuar metodat e luftës si ajo konvencionale, kibernetike dhe ka prodhuar armë të shkatërrimit në masë si bomba bërthamore, bakterologjike, etj.

A dëmton lufta psikologjinë ndër breza?

Psikologët evolucionarë sugjerojnë se është e natyrshme që grupet njerëzore të bëjnë luftë, sepse ne përbëhemi nga gjene egoiste që kërkojnë të përsëriten. Pra, është e natyrshme që të përpqemi të kapim burimet që na ndihmojnë të mbijetojmë dhe të luftojmë për to me grupe të tjera. Grupe të tjera rrezikojnë potencialisht mbijetesën tonë dhe kështu ne duhet të konkurrojmë dhe të luftojmë me ta.

Ka edhe përpjekje biologjike për të shpjeguar luftën. Burrat janë të përgatitur biologjikisht për të luftuar për shkak të sasisë së madhe të testosteronit që përmbajnë, pasi besohet gjerësisht se testosteroni është i lidhur me agresionin. Dhuna mund të lidhet gjithashtu me një nivel të ulët të serotoninës, pasi ka prova që kur kafshëve u injektohet serotonin, ato bëhen më pak agresive.

Megjithatë, këto shpjegime janë

shumë problematike. Për shembull, ato nuk mund të shpjegojnë mungesën e dukshme të luftës në historinë e hershme njerëzore, ose parahistorinë dhe mungesën relative të konfliktit në shumicën e shoqërive tradicionale të gjuetarë-mbledhësve. Kjo është një çështje e debatuar shumë dhe ka disa studiues dhe shkencëtarë që pohojnë se lufta ka ekzistuar gjithmonë në shoqëritë njerëzore.

Megjithatë, shumë arkeologë dhe antropologë e kundërshtojnë këtë, dhe unë besoj se provat janë fort në anën e tyre. Për shembull, vitin e kaluar antropologu Patrik Soderberg botoi një studim të dhunës në 21 grupe moderne të gjuetarë-mbledhësve dhe zbuloi se, gjatë 200 viteve të fundit, sulmet vdekjeprurëse nga një grup ndaj tjetrit ishin jashtëzakonisht të rralla. Ai identifikoi 148 vdekje nga dhuna midis grupeve gjatë kësaj periudhe dhe zbuloi se shumica e tyre ishin rezultat i konfliktit njëri-në-një, ose grindjeve familjare. Në mënyrë të ngjashme, antropologu R. Brian Ferguson ka mbledhur prova bindëse për të treguar se lufta është vetëm rreth 10 000 vjet e vjetër dhe u bë e shpeshtë vetëm rreth 6 000 vjet më parë.

Dhe një problem i teorive biologjike të luftës është se ndërsa ato mund të jenë në gjendje të shpjegojnë shpërthime specifike të dhunës, lufta është në fakt shumë më tepër se kaq. Lufta është një aktivitet shumë i planifikuar dhe i organizuar, kryesisht i kryer dhe i organizuar në situata jo të dhunshme, që nuk përfshin një pjesë të madhe të luftimeve.

Në një nivel social, lufta jep një ndjenjë uniteti përballë një kërcënimi kolektiv. Ai lidh njerëzit së bashku - jo vetëm ushtrinë e përfshirë në betejë, por të gjithë komunitetin. Ajo sjell atë që James e quajti disiplinë - një ndjenjë

kohezioni, me qëllime të përbashkëta. "Përpjekja e luftës" frymëzon qytetarët individualë (jo vetëm ushtarët) që të sillen me nder dhe joegoist në shërbim të një të mire më të madhe.

Në nivel individual, një nga efektet pozitive të luftës është se i bën njerëzit të ndihen më të gjallë, vigjilentë dhe më të zgjuar. Ajo jep kuptim dhe qëllim, duke kapërcyer monotoninë e jetës së përditshme. Siç thotë James, "Jeta duket e hedhur në një plan më të lartë fuqie". Lufta gjithashtu mundëson shprehjen e cilësive më të larta njerëzore që shpesh qëndrojnë të fjetura në jetën e zakonshme, si disiplina, guximi dhe vetëmohimi.

Egoizmi i kësaj lufte ka një emër!

Një faktor i dukshëm është nxitja për të rritur pasurinë, statusin dhe fuqinë. Një motivim kryesor i luftës është dëshira e një grupi njerëzish - zakonisht qeveritë - për të rritur fuqinë dhe pasurinë e



tyre. Grupi përpqet ta bëjë këtë duke pushtuar dhe nënshtruar grupe të tjera dhe duke rrëmbyer territorin dhe burimet e tyre.

Zgjidhni pothuajse çdo luftë në histori dhe do të gjeni disa variante të

këtyre shkaqeve: luftërat për të aneksuar territore të reja, për të kolonizuar toka të reja, për të marrë kontrollin e mineraleve ose naftës të vlefshme, për të ndihmuar në ndërtimin e një perandorie për të rritur prestigjin dhe pasurinë, ose hakmerret për një poshtërim të mëparshëm, i cili pakësoi fuqinë, prestigjin dhe pasurinë e një grupi. Konflikti aktual në Ukrainë mund të interpretohet pjesërisht në këto terma - rezultat i dëshirës së Rusisë për të rritur territorin dhe prestigjin e saj duke fituar kontrollin e Krimesë dhe duke iu përgjigjur goditjes së dobësimit të prestigjit të humbjes së qeverisë së saj të favorizuar në Ukrainë.


Së dyti, lufta është e lidhur ngushtë me identitetin e grupit. Qeniet njerëzore, në përgjithësi, kanë një nevojë të fortë për përkatësi dhe identitet që mund të shfaqet lehtësisht në etnicizëm, nacionalizëm ose dogmatizëm fetar. Na inkurajon që të kapemi pas identitetit të grupit tonë etnik, vendit ose fesë dhe të ndjejmë një ndjenjë krenarie për të qenë britanikë, amerikanë, të bardhë, të zinj, të krishterë, myslimanë, protestantë ose katolik.

Problemi me këtë nuk është aq shumë krenaria për identitetin tonë, por qëndrimi që krijon ndaj grupeve të tjera. Identifikimi ekskluzivisht me një grup të caktuar krijon automatikisht një ndjenjë rivaliteti dhe armiqësie me grupet e tjera. Krijon një mentalitet jashtë grupit, i cili mund të çojë lehtësisht në konflikt. Në fakt, shumica e konflikteve gjatë historisë kanë qenë një përplasje midis dy ose më shumë grupeve të ndryshme identitare - të krishterëve dhe myslimanëve në kryqëzata, hebrenjve dhe arabëve, hinduve dhe myslimanëve në Indi, katolikëve dhe protestantëve në Irlandë e Veriut, izraelitëve dhe palestinezëve, serbët, kroatët dhe boshnjakët, e kështu me radhë.

Përsëri, konflikti aktual në Ukrainë interpretohet lehtësisht në këto terma. Mosmarrëveshja mbi Krimenë qëndron në faktin se shumica e popullsisë së rajonit e identifikojnë veten si etnikisht rusë, ndërsa ukrainasit etnikë dëshirojnë të ruajnë identitetin e tyre të pavarur, larg ndikimit rus.

Çështja e ndjeshmërisë është gjithashtu e rëndësishme. Një nga aspektet më të rrezikshme të identitetit të grupit është ajo që psikologët e quajnë përjashtim moral. Kjo ndodh kur ne i tërheqim të drejtat morale dhe njerëzore grupeve të tjera dhe u mohojmë atyre respektin dhe drejtësinë.

Ne kemi fjalën, apel në emër të të cilit protestojmë, "Për jetën, familjen, atdheun", çdo komb ka hisen e vet të diellit, lereni ta shndrisë atë.



Nga kryetarja Kodheli, njëherazi zëvendësprezidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, u dha zotimi i fuqishëm për mbështetje nga pozicioni i saj në synimet tona në procesin e integritimeve euroatlantike dhe lobimin në vendet mosnjohëse, anëtare të NATO-s.



Komisioni Parlamentar për Politikë të Jashtme vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës

Në kuadër të vizitës dyditore, delegacioni i Komisionit për Politikën e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, kryesuar nga kryetarja znj. Mimi Kodheli, vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës. Me këtë rast, ata u pritën nga ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj dhe stafi i lartë i Ministrisë.

Në takimin e realizuar me këtë rast, u diskutua për nivelin e bashkëpunimit dhe planeve konkrete të deritashme mes dy vendeve tona në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Nga kryetarja Kodheli, njëherazi zëvendësprezidente e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, u dha zotimi i fuqishëm për mbështetje nga pozicioni i saj në synimet tona në procesin e integritimeve euroatlantike dhe lobimin në vendet mosnjohëse, anëtare të NATO-s.

Ndër shumë çështje të tjera të rëndësishme të diskutuara, nga të dyja palët u vlerësua nevoja për një qasje dhe bashkëveprim më të shtuar nga dy qeveritë tona, në kontekstin e ri gjeopolitik, si dhe sfidave potenciale që çenojnë mjedisin e sigurisë sonë dhe rajonit në përgjithësi.



● *Në takim u diskutua për nivelin e bashkëpunimit dhe planeve konkrete të deritashme mes dy vendeve tona në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.*



Presidentja Osmani: Forcimi i aleancave ekzistuese dhe krijimi i aleancave të reja mbetet qëllim strategjik i politikës sonë të jashtme

“Forcimi i aleancave ekzistuese dhe krijimi i aleancave të reja, qëllim strategjik i politikës sonë të jashtme.

Në përfundim të vizitës në Shtetin e Katarit jemi të lumtur që kjo ishte mundësi e shkëlqyer për ta vënë Kosovën në hartën ndërkombëtare të diskutimeve për sfidat aktuale globale, si faktor i dëshmuar për paqe dhe stabilitet. Kosova mund të jetë një vend i vogël në sipërfaqe, por zëri ynë është i fuqishëm dhe historia jonë është e rëndësishme për t'u dëgjuar në çdo cep të botës.

Përgjatë vizitës, pata mundësi që t'i takoj udhëheqësit e shtetit të Katarit, përfaqësues të shteteve njohëse e jonjohëse, miq të Kosovës dhe shtete me të cilat po punojmë t'i intensifikojmë raportet ndërshtetërore. Në fjalimin përmblyllës në Forumin e Dohas, para qindra pjesëmarrësve nga e gjithë bota, kam paraqitur perspektivën e Kosovës lidhur me zhvillimet e fundit globale.

Poashtu takova përfaqësues të komunitetit të biznesit me të cilët



shprehëm gatishmërinë e institucioneve tona për thellim të bashkëpunimit në fushat me potencial për investim në Kosovë, Fondacionin e Katarit si dhe institute nga vende të ndryshme. Asnjë vizitë nuk është e plotë pa

diskutime me komunitetin akademik dhe me bashkatdhetarët tanë, prandaj kisha kënaqësinë që t'u drejtohem edhe qindra studiuesve si dhe të bashkëbisedoj me shqiptarët që punojnë e veprojnë në Katar”.



Marrëveshja e Gjellbër: Deri në vitin 2030 produktet tekstile të vendosura në tregun e BE-së të jenë jetëgjatë dhe të riciklueshme

Propozime të reja për t'i bërë produktet e qëndrueshme normë dhe për të rritur pavarësinë e burimeve të Europës

Komisioni European po prezanton një paketë propozimesh për Marrëveshjen e Gjellbër Europiane, për t'i bërë produktet e qëndrueshme normë në BE, për të nxitur modelet qarkulluese të biznesit dhe për të fuqizuar konsumatorët për tranzicionin e gjellbër. Siç është paralajmëruar në Planin e Veprimit të Ekonomisë Qarkulluese, Komisioni po propozon rregulla të reja për t'i bërë pothuajse të gjitha mallrat fizike në tregun e BE-së më miqësore me mjedisin, qarkulluese dhe efikase ndaj energjisë gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor, nga faza e projektimit deri në përdorimin e përditshëm, duke ripërdorur dhe duke përfunduar vlefshmërinë. Komisioni po prezanton gjithashtu sot një strategji të re për t'i bërë tekstilet më të qëndrueshme, të riparueshme, të ripërdorshme dhe të riciklueshme, për të trajtuar modën e shpejtë, mbetjet e tekstilit dhe shkatërrimin e tekstileve të pa shitura dhe për të siguruar që prodhimi i tyre të bëhet në respekt të plotë të të drejtave sociale.

Një propozim i tretë synon të nxisë tregun e brendshëm për produktet e ndërtimit dhe të sigurojë që kuadri rregullator në vend është i përshtatshëm për të bërë që mjedisi i ndërtuar të përmbushë objektivat tona të qëndrueshmërisë dhe klimës.

Së fundi, paketa përfshin një propozim mbi rregulla të reja për të fuqizuar konsumatorët në tranzicionin e gjellbër, në mënyrë që konsumatorët të jenë më të informuar për qëndrueshmërinë mjedisore të produkteve dhe të mbrohen më mirë nga larja e gjellbër.

Me propozimet e sotme, Komisioni po paraqet mjetet për të kaluar në një ekonomi vërtet qarkulluese në BE: e shkëputur nga varësia nga energjia dhe burimet, më elastike ndaj goditjeve të jashtme dhe me respekt për natyrën dhe shëndetin e njerëzve. Propozimet bazohen në suksesin e rregullave ekzistuese të Ekodizajnit të BE-së, të cilat kanë sjellë reduktime të dukshme në konsumin e energjisë të BE-së dhe kursime të konsiderueshme për konsumatorët. Vetëm në vitin 2021, kërkesat ekzistuese të ekodizajnit u kursyen konsumatorëve 120 miliardë euro. Rregullat kanë çuar gjithashtu në një konsum vjetor 10% më të ulët të energjisë nga produktet në fushëveprim. Deri në vitin 2030, kuadri i ri mund të çojë në 132 milion toe (tonne of oil equivalent) kursime të energjisë primare, që korrespondon afërsisht me 150 bcm (billion cubic metres) gaz natyror, pothuajse e barabartë me importin e gazit rus nga BE.

Kthimi i produkteve të qëndrueshme në normë

Propozimi për një Rregullore mbi Ekodizajnin për Produkte të Qëndrueshme trajton dizajnin e produktit, i cili përcakton deri në 80% të ndikimit mjedisor të ciklit jetësor të një produkti. Ai vendos kërkesa të reja për t'i bërë produktet më të qëndrueshme, të besueshme, të ripërdorshme, të përmirësuara, të riparueshme, më të lehta për t'u mirëmbajtur, rinovuar dhe ricikluar, si dhe efikasitet të energjisë dhe burimeve. Përveç kësaj, kërkesat e informacionit specifike për produktin do të sigurojnë që konsumatorët të dinë ndikimet mjedisore të blerjeve të tyre. Të gjitha produktet e rregulluara do të kenë Pasaporta Dixhitale të Produkteve. Kjo do ta bëjë më të lehtë riparimin ose riciklimin e produkteve dhe do të lehtësojë gjurmimin e substancave shqetësuese përgjatë zinxhirit të furnizimit. Mund të futet edhe etiketimi. Propozimi përmban gjithashtu masa për t'i dhënë fund shkatërrimit



të mallrave të konsumit të pa shitur, si dhe për të zgjeruar prokurimin publik të gjellbër dhe për të ofruar stimuj për produkte të qëndrueshme.

Propozimi i sotëm zgjeron kuadrin ekzistues të Ekodizajnit në dy mënyra: së pari, për të mbuluar gamën më të gjerë të mundshme të produkteve; dhe së dyti, për të zgjeruar fushëveprimin e kërkesave me të cilat produktet duhet të përputhen. Vendosja e kriterëve jo vetëm për efikasitetin e energjisë, por edhe për qarkullueshmërinë dhe një reduktim të përgjithshëm të gjurmës mjedisore dhe klimatike të produkteve do të çojë në më shumë pavarësi energjike dhe burimesh dhe më pak ndotje. Ai do të forcojë tregun e vetëm, duke shmangur legjislacionin e ndryshëm në çdo Shtet Anëtar dhe do të krijojë mundësi ekonomike për inovacion dhe krijimin e vendeve të punës, veçanërisht në riprodhimin, mirëmbajtjen, riciklimin dhe riparimin. Propozimi do të përcaktojë një kornizë dhe një proces përmes të cilit Komisioni, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë personat e interesuar, do të përcaktojë në mënyrë progresive kërkesat për çdo produkt ose grup produktesh.

Së bashku me këtë propozim, Komisioni ka miratuar gjithashtu një Plan Pune për Ekodizajn dhe Etiketim të Energjisë 2022-2024 për të mbuluar produktet e reja të lidhura me energjinë, përditësimin dhe rritjen e ambicieve për produktet që tashmë janë të rregulluara, si masë kalimtare deri në hyrjen e rregullores së re në fuqi. Ai trajton veçanërisht pajisjet elektronike të konsumit (telefonat inteligjentë, tabletët, panelet diellore), rryma e mbetjeve me rritje më të shpejtë.

Për të mbështetur vendosjen e

produkteve të qëndrueshme në të gjithë tregun e BE-së, sot janë paraqitur edhe iniciativa sektoriale të synuara. Strategjia e BE-së për Tekstile të Qëndrueshme dhe Rrethore dhe rishikimi i Rregullores së Produkteve të Ndërtimit do të trajtojnë dy grupe produktesh prioritare me ndikime të rëndësishme.

Tekstile të qëndrueshme dhe qarkulluese

Konsumi european i tekstileve ka ndikimin e katërt më të lartë në mjedis dhe ndryshimet klimatike, pas ushqimit, strehimit dhe lëvizshmërisë. Është gjithashtu zona e tretë më e lartë e konsumit për përdorimin e ujit dhe tokës, dhe e pesta për përdorimin e lëndëve të para primare.

Strategjia e BE-së për Tekstile të Qëndrueshme dhe Qarkulluese përcakton vizionin dhe veprimet konkrete për të siguruar që deri në vitin 2030 produktet tekstile të vendosura në tregun e BE-së të jenë jetëgjatë dhe të riciklueshme, të përbëra sa më shumë që të jetë e mundur nga fibra të ricikluara, pa substanca të rrezikshme dhe të prodhuara në respektimi i të drejtave sociale dhe mjedisit. Konsumatorët do të përfitojnë më gjatë nga tekstilet me cilësi të lartë, moda e shpejtë duhet të jetë jashtë modës dhe shërbimet e ripërdorimit dhe riparimit ekonomikisht fitimprurëse duhet të jenë gjerësisht të disponueshme. Në një sektor tekstili konkurrues, elastik dhe inovativ, prodhuesit duhet të marrin përgjegjësinë për produktet e tyre përgjatë zinxhirit të vlerës, duke përfshirë kur ato bëhen mbetje. Në këtë mënyrë, ekosistemi rrethor i tekstileve do të lulëzojë dhe do të drejtohet nga kapacitete të mjaftueshme për riciklim

inovativ nga fibra në fibër, ndërkohë që djegia dhe depozitimi i tekstileve duhet të reduktohet në minimum.

Masat specifike do të përfshijnë kërkesat e ekodizajnit për tekstilet, informacion më të qartë, një pasaportë dixhitale të produktit dhe një skemë të detyrueshme të përgjegjësisë së zgjeruar të BE-së. Ai gjithashtu parashikon masa për të trajtuar çlirimin e paqëllimshëm të mikroplastikës nga tekstilet, për të siguruar saktësinë e pretendimeve të gjellbra dhe për të nxitur modelet qarkulluese të biznesit, duke përfshirë ripërdorimin dhe shërbimet e riparimit. Për të adresuar modën e shpejtë, Strategjia u bën thirrje gjithashtu kompanive të zvogëlojnë numrin e koleksioneve në vit, të marrin përgjegjësi dhe të veprojnë për të minimizuar gjurmët e tyre të karbonit dhe mjedisit, dhe nga Shtetet Anëtare që të miratojnë masa të favorshme tatimore për sektorin e ripërdorimit dhe riparimit. Komisioni do të promovojë ndryshimin edhe me aktivitete ndërgjegjëse.

Strategjia synon gjithashtu të ofrojë mbështetje dhe të shoqërojë ekosistemin e tekstilit gjatë gjithë rrugëtimit të tij transformues. Prandaj, Komisioni po nis sot bashkë-krijimin e një rruge tranzicioni për ekosistemin e tekstilit. Ky është një mjet thelbësor bashkëpunimi për të ndihmuar ekosistemin të rikuperohet nga ndikimet negative të pandemisë Covid-19 që kanë ndikuar kompanitë në operacionet e tyre të përditshme për dy vitet e fundit. Ajo gjithashtu do të forcojë kapacitetet e tyre për t'i bërë ballë konkurrencës së ashpër globale dhe goditjeve të ardhshme për mbijetesën e tyre afatgjatë. Të gjithë aktorët inkurajohen të marrin pjesë aktive në procesin e bashkë-krijimit përmes angazhimeve të tyre për qarkullimin dhe modelet qarkulluese të biznesit, veprimet për të forcuar konkurrencën e qëndrueshme, dixhitalizimin dhe elasticitetin, si dhe identifikimin e investimeve specifike të nevojshme për tranzicionin binjak.

Produktet e ndërtimit të së nesërme

Ekosistemi i ndërtimit përfaqëson pothuajse 10% të vlerës së shtuar të BE-së dhe punëson rreth 25 milionë njerëz në mbi 5 milionë firma. Industria e produkteve të ndërtimit numëron 430 000 kompani në BE, me një qarkullim prej 800 miliardë eurosh. Këto janë kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Ato janë një aset kyç ekonomik dhe social për komunitetet lokale në rajonet dhe qytetet europiane.

Ndërtesat janë përgjegjëse për rreth 50% të nxjerrjes dhe konsumit të burimeve dhe më shumë se 30% të mbetjeve totale të BE-së të gjeneruara në vit. Për më tepër, ndërtesat janë përgjegjëse për 40% të konsumit të energjisë në BE dhe 36% të emetimeve të gazeve serrë të lidhura me energjinë.

Rishikimi i Rregullores për Produktet e Ndërtimit do të forcojë dhe modernizojë rregullat në fuqi që nga viti 2011. Ajo do të krijojë një kuadër të harmonizuar për të vlerësuar dhe komunikuar performancën

mjedisore dhe klimatike të produkteve të ndërtimit. Kërkesat e produkteve të reja do të sigurojnë që dizajni dhe prodhimi i produkteve të ndërtimit të bazohet në teknologjinë moderne për t'i bërë këto më të qëndrueshme, të riparueshme, të riciklueshme dhe më të lehta për t'u riprodhuar.

Gjithashtu do ta bëjë më të lehtë për organet e standardizimit të bëjnë punën e tyre për krijimin e standardeve të përbashkëta europiane. Së bashku me kapacitetet e zgjeruara të mbikëqyrjes së tregut dhe rregulla më të qarta për operatorët ekonomikë përgjatë zinxhirit të furnizimit, kjo do të ndihmojë në heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të tregut të brendshëm. Së fundi, rregullorja e rishikuar do të ofrojë zgjidhje dixhitale për të reduktuar barrën administrative, veçanërisht për SME-të, duke përfshirë një bazë të dhënash të produkteve të ndërtimit dhe një pasaportë të produkteve dixhitale.

Zëvendës presidenti Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjellbër Europiane Frans Timmermans tha: “Është koha për t'i dhënë fund modelit të “merr, bëj, thyej dhe flak”, që është kaq i dëmshëm për planetin tonë, shëndetin dhe ekonominë tonë. Propozimet e sotme do të sigurojnë që vetëm produktet më të qëndrueshme të shiten në Europë. Ato i lejojnë konsumatorët të kursejnë energji, të riparojnë dhe të mos zëvendësojnë produktet e prishura dhe të bëjnë zgjedhje të zgjuara mjedisore kur blejnë të reja. Kjo është mënyra se si ne rivendosim ekuilibrin në marrëdhënien tonë me natyrën dhe zvogëlojmë cenueshmërinë tonë ndaj ndërprerjeve në zinxhirët e furnizimit global.”

Komisioneri për Tregun e Brendshëm Thierry Breton tha: “Konsumatorët europianë me të drejtë presin produkte më miqësore me mjedisin dhe me jetëgjatësi. Më shumë qëndrueshmëri dhe efikasitet burimesh do të thotë gjithashtu më shumë elasticitet kur një krizë prish zinxhirët tanë të furnizimit industrial. Duke shfrytëzuar potencialin e Tregut të Vetëm, duke shfrytëzuar maksimalisht mjetet dixhitale dhe duke përmirësuar mbikëqyrjen e tregut, ne do të maksimizojmë mundësitë për bizneset dhe konsumatorët. Efikasiteti më i madh i burimeve dhe energjisë në sektorët e ndërtimit dhe tekstilit në veçanti do të gjenerojë vende pune me kualifikim të lartë në të gjithë Europën.”

Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin, Virginijus Sinkevicius tha: “Propozimet tona të ekonomisë qarkulluese nisin një epokë ku produktet do të dizajnohen në një mënyrë që sjell përfitime për të gjithë, respekton kufijtë e planetit tonë dhe mbron mjedisin. Dhënia e një jetëgjatësie më të madhe telefonave që përdorim, rrobave që veshim dhe shumë produkteve të tjera do të kursejë para për konsumatorët europianë. Dhe në fund të jetës së tyre, produktet nuk do të jenë burim ndotjeje, por materiale të reja për ekonominë, duke ulur varësinë e bizneseve europiane nga importet”.



1 prilli "historik" i shqiptarëve

Çfarë është NATO?

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior, Akronym OTAV është blloku perëndimor ushtarak. Kjo organizatë u themelua me firmosjen e Traktatit Atlantiko-Verior, më 4 prill 1949 me qëndër në Bruksel. Organizata ka themeluar një sistem mbrojtjeje kolektive ku vendet anëtare bien dakord të mbrojnë njëra-tjetrin në rast sulmi nga një palë e jashtme. Pas përfundimit të ratifikimit të protokollit të anëtarësimit nga të gjitha vendet anëtare dhe depozitimit të instrumentit të aderimit në NATO, në Departamentin Amerikan të Shtetit, Shqipëria u anëtarësua zyrtarisht në NATO, më 1 prill 2009.

Shqipëria shënon 13 vjet anëtare e NATO-s

Gjatë regjimit komunist Shqipëria ishte pjesë e Traktatit të Varshavës, blloku ushtarak i vendeve komuniste të Evropës, ku ishte anëtarësuar që në vitin 1955, ndërsa u largua nga ky bllok në vitin 1968.

Pas përmbysjes së regjimit komunist, Shqipëria përcaktoi integrimin euroatlantik si një objektiv strategjik për vendin, duke mos ndërprerë proceset e integritetit dhe duke u angazhuar në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të këtij procesi. Ky proces, për rreth 17 vite me radhë, ka kaluar nëpër sfida dhe angazhime të ndryshme të vendit, si në politikën e brendshme ashtu edhe në politikën e jashtme.

Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO ka kaluar në disa momente kryesore, që fillon me vitin 1992, ku vendi pranohet zyrtarisht në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC). NACC ishte organizmi i parë që krijoi Aleanca për të ndërtuar marrëdhëniet me shtetet që dolën nga regjimet komuniste në Evropën Lindore dhe Evropën Qendrore.

Që nga ai vit, pavarësisht se cilat forca politike kanë drejtuar qeveritë gjatë viteve të tranzicionit dhe deri në anëtarësimin me të drejta të plota, janë të shumta nismat dhe proceset ku është përfshirë Shqipëria, edhe misionet ushtarake paqeruajtëse në



vende të ndryshme të botës.

Në vitin 1999, Shqipëria u pranua si vend aspirant për anëtarësim, ndërsa procesi hyri në një fazë të re, duke u intensifikuar angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të këtij procesi i cili kishte edhe mbështetje ndërkombëtare. Më pas, po këtë vit Shqipëria paraqiti për herë të parë Planin e Veprimit për Anëtarësim në NATO.

Në kuadër të proceseve dhe nismave për integrimin në NATO, në maj të vitit 2003, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia (sot Maqedonia e Veriut), së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) nënshkruan Kartën Adriatike 3-SHBA, që u konsiderua si një nismë që do të përgatiste hyrjen e tre shteteve në NATO.

Gjatë viteve 2004-2008, Shqipëria vazhdoi procesin e bashkëpunimit me Aleancën dhe për përmbushjen e objektivave të partneritetit, që përcaktonte disa masa për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, me qëllim për të operuar së bashku me forcat e NATO-s.

Shqipëria mori ftesën për anëtarësim në NATO, në samitin e Bukureshtit, më 2 prill 2008. Më 25 prill 2008 Shqipëria filloi zyrtarisht bisedimet për anëtarësimin, bised-

ime që përfshinin disa çështje politike, ushtarake, sigurie dhe ligjore. Ndërsa më 9 korrik 2008, vendet anëtare të NATO-s nënshkruan në Bruksel protokollet e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Kroacinë.

Pas përfundimit të ratifikimit të protokollit të anëtarësimit nga të gjitha vendet anëtare dhe depozitimit të instrumentit të aderimit në NATO, në Departamentin Amerikan të Shtetit, Shqipëria u anëtarësua zyrtarisht në NATO, më 1 prill 2009.

Shqipëria mori për herë të parë pjesë si anëtare me të drejta të plota e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, në samitin që u

mbajt në Strasbourg/Kehl, më 4 prill 2009, ndërkohë që më 7 prill 2009, në selinë e Aleancës në Bruksel, u zhvillua ceremonia zyrtare e ngritjes së flamujve të Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO.

Para, por edhe pas anëtarësimit, Shqipëria ka ofruar kontributin e saj në operacionet ndërkombëtare të paqes të drejtuara nga NATO, por edhe nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, nga viti 1994 kur filloi edhe angazhimi në misionet ndërkombëtare dhe deri

sot, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, kanë kontribuar një personel prej më shumë se 6982 ushtarakësh të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria është bërë pjesë e dhjetëra operacioneve dhe misioneve ndërkombëtare në Kosovë, Bosnje-Hercegovinë, Mali, Detin Egje, Letoni, Irak dhe Afganistan, ndërsa gjatë 10 viteve si pjesë e Aleancës, forcat e armatosura janë përfshirë në një proces transformimi dhe modernizimi, që nga personeli dhe deri te pajisjet dhe mjetet ushtarake. Shqipëria feston 13-vjetorin e anëtarësimit të saj në NATO. Dita historike e 1 prillit të vitit 2009, e cila përkon edhe me 60-vjetorin e krijimit të Aleancës, futi vendin si anëtare me drejta të plota në Aleancën më të suksesshme që ka njohur koha.

Aleanca, me vlerat, me garancinë që i dha lirisë, bëri të mundur që sistemi i vlerave të ngadhënjë në mbarë botën e lirë. Aleanca e Atlantikut të Veriut, u shndërrua në faktorin më përcaktues të shembjes së murit të Berlinit dhe të çlirimit të mbi 400 milion qytetarëve të Evropës dhe Azisë Qendrore, që lëngonin nën shtypjen e egër të regjimeve totalitare. Por, në dallim nga mbarë popujt e tjerë, për ne, flamuri i NATO-s, krahas flamurit kombëtar, është flamuri i shenjtë i shqiptarëve. Ky ishte flamuri, i cili 23 vite më parë, çliroi së bashku me flamurin kombëtar, 2 milion shqiptarët që po përjetonin barbaritë, mizoritë më të egra në Kosovë. Me çlirimin e Kosovës, flamuri i NATO-s është flamuri i dytë, krahas flamurit kombëtar, është flamuri i dinjitetit tonë, është flamuri që i bëri të lirë shqiptarët, u dha atyre të drejtën, mundësinë të këndojnë këngën e lirisë, të ndërtojnë të lirë të ardhmen e tyre, në trojet mijëvjeçare ku jetonin.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

KAFSHËT LUFTËTARE SI DHE NJERËZIT

Luftërat janë një e keqe e njerëzimit, i artit të shkatërrimit, që kanë lindur bashkë me shoqëritë njerëzore dhe janë bashkëshoqëruese të tyre. Kafshët janë gjithashtu shërbëtorë të njerëzimit në situatë paqësore, por dhe në situatë luftarake. Nuk janë të rralla rastet kur kafshët janë përfshirë në luftëra bashkë me njerëzit, veçanërisht në kohët parahistorike e deri në ditët tona. Elefantët, devetë, kuajt, qentë, arinjë janë bërë padashur “luftëtarë”, kanë luftuar bashkë me njerëzit, kanë qenë në front dhe në prapavijë. Në përballjet luftarake të përgjakshme nëpër shekuj kafshët e luftës janë vrarë, plagosur e ngordhur, ndoshta më shumë se të zotët e tyre. Këtu nuk e kemi fjalën për qentë e kufirit, të policisë dhe jo vetëm, dhe as për qenin “Sadak”, qeni hero që shpëtoi shumë jetë në Thumanë dhe Durrës si mjeshtër i kërkimit në rrënojat e pallateve në tërmetin e 26.11.2019, as për qen heronj që kanë shpëtuar jetën e sa e sa foshnjave, apo për qentë e salloneve presidenciale kudo në botë, që nderohen më shumë se njerëzit. Fjala është për qenin hero të Luftës së Parë Botërore, për Rreshterin “Stabi”, një hero i vërtetë që kapërceu Atlantikun dhe iu gjend europianëve në kohë rreziku. Lufta e Parë Botërore apo Lufta e Madhe ishte lufta që përfshiu pothuajse gjithë botën, nga viti 1914 deri më 1918. Shtetet e Bashkuara i shpallën luftë Gjermanisë më 6.4.1917 dhe më 7.12.1917, i shpallën luftë Austro-Hungarisë. Në rrugëtimin luftarak në të dy luftërat botërore nuk munguan kafshët besnike të njerëzimit veçanërisht qeni dhe kali, por edhe kafshë-egërsira si ariu, që rriteshin mes njerëzve dhe imitonin ata, sikurse ishte ariu “Wojtek”, qeni “Stubby” e deri tek historitë frymëzuese të qenit ushtarak “Kuno”, gjatë një bastisjeje ka shpëtuar jetën e ushtarëve britanikë të cilët po luftonin al-Kaedën në Afganistan në gusht 2020. Qeni hero në momentin kur armiku po gjuante me armë zjarri ka dalë para plumbave dhe si pasojë e kësaj humbi të dyja këmbët e pasme. Qenit-hero pasi humbi këmbët në operacion luftarak iu porositën proteza, duke bërë që të jetë qeni i parë ushtarak në Mbretërinë e Bashkuar që i porositet diçka e tillë. Qeni Kuno, i trajnuar për të zbuluar eksplozivë dhe armë, iu dha medalja për trimëri në një ceremoni virtuale sepse në momentin e sulmimit ishin pozicionuar për të mbështetur forcat elitare të Shërbimit Special të Anijeve, ndërkohë që është “pensionuar”. Janë të njohur historikisht kali i Gjergj Kastriotit, si simboli që ka shoqëruar heroin dhe sipas Barletit, ishte i bardhë, i një race të zgjedhur, që pas vdekjes së heroit, ai nuk pranoi t’i hipte njeri tjetër deri sa ngordhi; kali që kalëronte Napolon Bonoparti, “Marengo”, një kal i bukur arab që ka hyrë në histori si më i famshmi nga të gjithë si dhe qindra figura të gjeneralizmit botëror. Kuajt kanë parë betejat nga më të përgjakshmet të njerëzimit, prerje kokash, krime të përbindshme. Po kështu edhe elefantët me fizikun e tyre të fuqishëm janë shfrytëzuar nga njerëzit në kohë lufte, duke i vendosur në ballë të ushtrisë, si mburojë, ndërkohë që elefantët përdoret për të sulmuar ushtarët e armikut, prandaj ai është në formë heshte, sikurse mban pesha shumë të rënda bashkë me devetë. Dhjetra prijësa luftarakë, në betejat e mëdha të historisë përdorën elefantë, kuaj e deve si dhe kafshë të tjera lufte. Këtu përfshihet edhe Pirro i Epirit, Aleksandri, Hanibali etj. Faktikisht gjithë prijësit e fushatave luftarake kishin për

Elefantë, kuaj, qen, arinj, deve,.. pëllumba janë bërë padashur “luftëtarë” dhe janë përfshirë në betejat të përgjakshme të “artit të shkatërrimit” të njerëzimit. Suksesin dhe famën më të madhe në lufta e ka arritur qeni amerikan “Stabi”, si luftëtar në LIB, hero, i graduar “Rreshter”, i dekoruar më shumë se çdo kafshë lufte përfshi medalje ari, i pritur në audiencë nga tre presidentë të SHBA-së, nekrologjia për qenin Stabi zinte vend në “The New York Times” në një hapësirë gazete dy herë më të madhe se sa lejohej për vdekjet e kryeministrave të vendeve miq të SHBA-së)



të New Haven, në Connecticut të SHBA-së, në pritje për t’u hedhur në frontet e Luftës së Parë Botërore në Europë. Por diku midis kazermave, gjeti një këlysh bisht-cung, të vogël e të uritur, qeni me sytë e mëdhenj e trupi gjithë muskuj i pitbullit. Konroi ishte një dashamirës i kafshëve dhe si i tillë e mori këlyshin, për të cilin koha tregoi se shpejt ai do të bëhej i njohur dhe i dashur për të gjithë ushtarët dhe oficerët e Regjimentit 102 të Këmbësorisë Amerikane. Efektivit të regjimentit iu shtua edhe një “ushtar”, duke i bërë shoqëri Robert Konroi.

Meqenëse qeni ishte me bisht të shkurtër, ushtarët filluan ta thërrisnin këlyshin me emrin Stabi (Stubby), që në shqip nënkupton “cung” apo bishtprerë. Stabi u mësua me jetën e kazermës dhe me gjithë jetesën ushtarake, u njoh me alarmet, stërvitjet, mësoi si të përshëndeste ushtarakisht duke u ngritur mbi dy këmbët e pasme e të vinte putrën tek vetulla e djathtë. Ditët kalonin dhe erdhi koha që trupat të niseshin për në Europë, në Regjimentin e 102-të të Këmbësorisë, ku bente pjesë dhe Konroi, do të lundronte me anijen luftarake “S.S.Minesota”. U nisën bashkë me Stabin dhe pas disa ditësh, kur anija ishte larg në oqean, komandanti i Regjimentit, ku ishte ushtar Konroi, zbuloi se ushtarët e tij kishin edhe një qen me vete gjatë udhëtimit, duke kaluar Atlantikun. Kjo e zemëroi shumë sa urdhëroi kapjen e menjëherëshme të qen-bishtprerit.

Urdhëri u zbatua, por në momentin që komandanti po mendonte për ekzekutimin e tij, ai u habit sepse qeni përballë u ngrit mbi dy këmbët e pasme dhe nderoi ushtarakisht duke mbështetur putrën e djathtë mbi vetull, duke pritur Urdhërin e ekzekutimit, apo të flakjes në oqean. Komandanti i Regjimentit nuk mundi t’i rezistonte një gjesti të tillë nderues edhe në prag ekzekutimi, komandanti i dha leje të jetonte dhe pranoi ta rekrutonte në efektivin e tij.

Gradimi “rreshter” i “Stubby-it” si luftëtar i denjë i frontit

Me mbërritjen në Francë, regjimenti i Konroi, iu bashkua Divizionit të 26-të të “Yankee”-t dhe u nis për në llogoret e luftës, duke u futur kështu në një periudhë prej tetë muajsh luftimesh të përgjakshme. Bashkë me regjimentin luftonte dhe Stabi, një qen i vogël e i zgjuar, që nuk ishte thjeshtë një “luftëtar fronti”, por më shumë se një kafshë e thjeshtë, një thesar mbështetës në fushën e betejës luftarake. Stabi

sur në ballë të ushtrisë, si mburojë, ndërkohë që elefantët përdoret për të sulmuar ushtarët e armikut, prandaj ai është në formë heshte, sikurse mban pesha shumë të rënda bashkë me devetë. Dhjetra prijësa luftarakë, në betejat e mëdha të historisë përdorën elefantë, kuaj e deve si dhe kafshë të tjera lufte. Këtu përfshihet edhe Pirro i Epirit, Aleksandri, Hanibali etj. Faktikisht gjithë prijësit e fushatave luftarake kishin për

shok të parë kalin, të shpejtë dhe të fuqishëm, deri sa “i ra vlera” me daljen e makinave luftarake motorike si dhe helikopterët, si vendkomanda lufte në ajër. Historia si dëshmitare e kombeve ka hedhur dritë dhe ka ndriçuar rrugët e kujtesës si për njerëzit ashtu edhe për kafshët që luftuan në betejat e historisë. **Qeni hero - nga Amerika në Europë, si luftëtar i barabartë me njerëzit**

Më 11.11.1918, Gjermania nënsh-

kroi një marrëveshje armëpushimi me aleatët, për përfundimin e LIB, që njihej si “lufta për t’i dhënë fund të gjitha luftërave”, ku ndërmjet mijëra historive të vërteta të fushëbetejave dallon historia e një qeni që bëri histori më vete gjatë Luftës së Parë Botërore. Ka qenë korriku i 1917-ës, kur ushtari 25 -vjeçar Robert Konroi (Conroy), stërvitej bashkë me shokët e tij të regjimentit në një bazë ushtarake të improvizuar në Yale

kishte mësuar shumë nga jeta intensive ushtarake, e ndjente instiktivisht kur jeta ishte në rrezik dhe i mbronte shokët e tij ushtarë të transheve, me të njëjtën trimëri e vendosmëri që çdo qen tjetër në botë do të mbronte të zotin e tij në rrethana të vështira lufte.

Stabi i përcillte me ulërime shokët e tij ushtarë të transheve, që jepnin jetën me tmerr, herë të copëtuar nga minat apo predhat e artilerisë e herë duke vjellë copa mushkërishë si pasojë e sulmeve kimike të armiqve, armë kimike të sapozbuluara dhe të provuara për herë të parë në LIB. Në këtë situatë edhe Stabi u gjend përballë sulmit kimik me klorinë të gjermanëve. Ushtria e kishte kalitur dhe ai i mbijetoi sulmit kimik. Pas kësaj ngjarjeje Stabi u bë edhe më i ndjeshëm ndaj klorinës dhe një nuhatës e paralajmërues për ushtarët e tjerë të frontit, sado larg që parapërgatitej hedhja e saj. Aftësitë e tij të reja u panë në një mëngjes herët, kur gjermanët, duke përfutur nga drejtimi i erës, filluan pa paralajmërim një sulm të ri kimik me klorinë mbi vendqëndrimet e ushtarëve amerikanë që ishin akoma në gjumë. Stabi u bë kështu një paralajmërues i rrezikut, duke bërë zgjimin e amerikanëve duke lehur fort, duke kërcyer mbi shtretërit e ushtarëve dhe duke dhënë kështu alarmin e duke shpëtuar jetë të shumta. Kur ushtarët ishin të dërrmuar në luftime dhe të sflitur nga lodhja ishte një “ushtar” vigjilent dhe i gatshëm gjithmonë. Ai ishte në kohë të mirë dhe të keqe, ditën dhe natën i gatshëm, në betejë dhe në pushimet e përkohshme të sulmeve. Qeni “Stabi” ishte shndërruar në luftëtar me kohë të plotë në betejë. Ai ishte zbulues dhe nuhatës i minave, futej në hapësirat midis transheve dhe kërkonte për ushtarë të vrrarë e të plagosur. U shndërrua në një sinjalizues tepër të saktë kur gjente ushtarë amerikanë, ndërsa e lehura kërcënuese donte të thoshte se kishte gjetur një ushtar armik. Në një rast, në një prej betejave, identifikoi dhe një spiun gjerman të cilin e sulmoi dhe nuk iu nda derisa trupat amerikane e kapën atë.

Akti trimëror i Stabit bëri që gjenerali komandues i trupave amerikane të dekretonte për Stabin urdhërin për dhënien e gradës “Rreshter”, e panjohur dhe e padëgjuar më parë, duke u bërë rasti i parë në historinë e Luftërave që një qen të merrte një gradë ushtarake, që u përkiste rracës njerëzore. Edhe i zoti i qenit u bë “xheloz” se nuk përparoi dot në gradë, megjithëse ishte krenar për Stabin e tij. Si asnjëherë tjetër në historinë e ushtrisë amerikane, në Regjiment vjen urdhëri që “Rreshteri Stabi” të pajisej me një uniformë të veçantë të posaçme, dhe në fakt kjo uniformë e Stabit ruhet edhe pas më shumë se një shekulli në Muzeun “Smithsonian” në Washington DC, në kryeqendrën e SHBA-së. Fakt historik është se Rreshter Stabi, shërbeu denjësisht me kontribut të spikatur në 17-të betejë, derisa nga fundi i luftës, një granatë që shpërtheu afër tij e plagosi rëndë në gjoks dhe në këmbë. Rreshteri Stabi shkroi faqe lavdie në përdorimin e kafshëve në luftë, evitoi rreziqe në luftime, kurseu gjak nga “shokët” e luftës,



Bashkë me regjimentin luftonte dhe Stabi, një qen i vogël e i zgjuar, që nuk ishte thjeshtë një “luftëtar fronti”, por më shumë se një kafshë e thjeshtë, një thesar mbështetës në fushën e betejës luftarake. Stabi kishte mësuar shumë nga jeta intensive ushtarake, e ndjente instiktivisht kur jeta ishte në rrezik dhe i mbronte shokët e tij ushtarë të transheve me të njëjtën trimëri e vendosmëri, që çdo qen tjetër në botë do të mbronte të zotin e tij në rrethana të vështira lufte.

nuhati dhe parandaloi helmimin me një re me gaz mustardë të verdhë-gjelbër, që kishte mbështjellë një qytet, si një mjegull vdekjeprurëse, me mençuri u bë zbulues, që nuk njohu kurrë ankesa, por gjithmonë besnik i regjimentit ku shërbeu, më i dekoruari në historinë e njerëzimit, i pritur nga Presidentë të SHBA-së.

Përshkrimet e kohës ruhen dhe tregohen se si në spitalin ushtarak ku u mjekua, qeni i famshëm nga New Haven i Connecticut, pasi e kishte marrë pak veten, ngrihej e shoqëronte gjithë dinjitet grupin e oficerëve mjekë, thua sikur ta

dinte që ai ishte dhe vetë një i tillë, duke sjellë kurajo, optimizëm dhe gëzim tek të plagosurit e tjerë, që mbushnin spitalin në ato ditë të fundit të LIB. Rreshteri Stabi u bë i njohur në të dy anët e Atlantikut. Gazetat e luftës e përmendnin shpesh emrin e tij, kjo që bëri që gratë e Chateau-Thierrey, një nga komunat franceze, ku në vitin 1918 u zhvilluan disa betejë të përgjakëshme midis amerikanëve e gjermanëve, t'i qepnin Rreshterit Stabi një pallto të veçantë kamoshi, tashmë e njohur në rrethet gazetareske të mbushur plot me dekorata e medalje “për trimëri

në luftë”. Përfundimi i luftës bëri që luftëtari i frontit luftarak në Europë të kthehej fitimtar në shtëpinë e tij në SHBA, si një hero, por dhe me një medalje ari të akorduar nga organizata “Humane Society”, që kryesohej nga gjenerali John J. Pershing, komandant i Përgjithshëm i Forcave Amerikane. Fama e Stabit pas lufte u rrit shumë dhe ai filloi të ishte shpesh e më shpesh një i ftuar i çuditshëm dhe i respektuar në aktivitete shumë të rëndësishme. U harrua i zoti i qenit, por qeni i tij kurrë. Ai u prit në audiencë nga tre presidentë të

Shteteve të Bashkuara, nga Presidenti Wilson, Presidenti Harding dhe Presidenti Coolidge. Institucionet dhe autoritet amerikane, dhe jo vetëm, për shërbimet e kryera i dhanë dekorata, medalje, urdhëra e tituj nderi përfshi edhe anëtarësinë në Legjionin Amerikan të Nderit. Stabi u bë veteran lufte, u tërhoq nga shërbimi aktiv njëherësh me të zotin e tij, Konroin, i cili në vitin 1921 shkoi për të studiuar drejtësi në Universitetin Georgetown të Washingtonit. Por me student Konroin si në luftë edhe në paqe ishin bashkë. E mori qenin me vete si shokun e tij më të ngushtë. Dy veteranë lufte shkuan bashkë edhe në Universitet, bashkë me rreshter Stabin. Qenit besnik të rregjimentit, bashkëluftëtar në frontet e luftës në Europë, kur ishte vetëm 10 vjeç, më 16.3.1926, i pushon zemra në mënyrë të papritur, që nuk ishte një ngordhje por një vdekje e transmetuar nga gjithë media e politika amerikane e kohës, si vdekja e një hero lufte. Gazeta prestigjioze e planetit “The New York Times” shkroi nekrologji të tillë, që zinte një hapësirë gazete dy herë më të madhe se sa lejohej për vdekjet e kryeministrave të vendeve miq të SHBA-së. Trupi me katër putra i rreshter Stabit u balsamos dhe sot ai qëndron në pavionin “Price of Freedom”/Çmimi i Lirisë të Muzeumit Kombëtar të Historisë së Natyrës në Washington DC të SHBA-ve, muzeu i famshëm që njihet në mbarë botën “Smithsonian National Museum of Natural History”. Skulptura, piktura, memoriale kushtuar rreshterit Stabi, janë të përhapura dhe të njohura kudo. Stabi ka një memorial në Parkun Përkujtimor të Veteranëve të Middletown të Connecticut të SHBA-ve, memorial përkujtimor për qentë e luftës në Filadelfia, ndërkohë që sa ishte gjallë Stabi ishte pjesë e paradave të fitores pas Luftës së parë Botërore. Edhe në Michigan ka një varrezë qensh, që kanë shërbyer denjësisht në ushtri dhe në policinë amerikane. Brezat tashmë kanë mësuar për qenin hero të LIB, që në të vërtetë ka më shumë se 50 burime studimi për një qen hero, që u fut në luftë kur ishte një vjeç rastësisht dhe ngeli “hero lufte”. Në Kansas City, në një rrugë që u kushtohet luftëtarëve që luftuan për Amerikën dhe lirinë e popujve europianë, që quhet “Walk of Honor”, çdo tullë e shtruar ka një emër veterani, gjen edhe një emër: “Rreshter Stabi”, qeni veteran i Luftës së Parë Botërore, qeni me gradën më të lartë se i zoti, fitues i medaljes “Purple Heart”, por meritoi dhe shumë medalje “Për trimëri”. Qeni ka emrin edhe në “Monumentin e Lirisë për Ushtarakët e Luftës së Parë Botërore, të dedikuar: “Sergeant Stubby, Hero Dog of WWI, A Brave Stray”, “qenit të luftës” si ikonë e Luftës së Parë Botërore, hero e mik i presidentëve, gjeneralëve e ushtarëve, i respektuar kudo dhe në institucionet ushtarake dhe akademike, i vizituar nga miliona njerëz në vit, subjekt legjendash si hero lufte për shërbimin me besnikëri ndaj njerëzve në betejë.



Rreshter Sazan Pashollari dhe tetar Muhamet Meçorrapaj gjenden shpesh përballë detyrave dhe situatave të befasishme

Krenarë për punën dhe pasionin e zhytësve tanë

